



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0014451/26 dt. 18.03.2026**  
**Mitrovicë**

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për të **premtën** më dt. **27.03.2026**:

**T H Ë R R E T**  
**Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës**  
**(Mbledhja e 7-të)**

Mbledhja do të ketë këtë REND DITE:

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
2. Draft-Rregullorja për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale
3. Propozim vendim për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026
4. Propozim-vendim për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elijona Brahimi
5. Propozim vendim për formimin e komiteteve konsultative
6. Propozim vendim për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës
7. Kërkesë për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë
8. Raport mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026
9. Raporti financiar i komunës për realizimin e buxhetit komunal janar - dhjetor 2025
10. Pyetje dhe përgjigje

**Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.**

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit  
  
Safet KAMBERI





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## **KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Nr. 02-060/01-0005630/26 dt. 10.02.2026**

**Mitrovicë**

### **PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës**

**Seanca e 4-të**

**Koha:** 10.02.2026, ora 10:00

**Vendi:** Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

**Të pranishëm:** Anëtarët e Kuvendit: Safet Kamberi, Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Igballe Islami, Ferdi Kadriu, Artan Berisha, Egzon Hamza, Gëzim Stavileci, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Liridona Muharremi, Nazmije Sejdiu, Lavdim Zeneli, Armend Begu, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Rinesa Preteni, Sazan Ramaxhiku, Bajram Istrefi, Visar Syla, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Rozana Peci, Oltion Ahmeti, Xhyljeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesesi i Kuvendit z. Safet Kamberi, i cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, anëtarët të Kuvendit, përfaqësuesit e Ministrisë së Pushtetit Lokal të cilët monitorojnë përmes teleprezencës, organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, media dhe të pranishmit tjerë. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit theksoi Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 4-të të rregullt të Kuvendit të Komunës, me rend dite siq është paraparë me thirrje (lexoi rendin e ditës).

Hap diskutimin rreth rendit të ditës.

Valon Brahimi: Fillimisht, uroi kabinetin e ri. Me rastin e 27-vjetorit të rënies së dëshmorit Avni Kushtova, propozoi që në rend të ditës të futen dy pika për diskutim:

Rruga “Gëzimi i Parë”, që çon te ura e re pranë palestrës, të emërtohet me emrin e dëshmorit Avni Kushtova.

Ura te Tre Rokaçejtë të futet në rend të ditës për iniciimin e procedurës për emërtim në emër të ish-kryeministrit të Kosovës, doktor Bajram Rexhepi.

Gëzim Stavilevci: Të nderuar anëtarë të kabinetit qeverisës, të dashur kolegë, në pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës, që ka të bëjë me ndarjen e bursave, propozoj që numri i bursave të jetë pa limit, duke u bazuar në tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit të kaluar. Po ashtu, propozoj që në

Rregulloren nr. 02/2020 të ndryshohet pika që përcakton se bursat u ndahen vetëm studentëve të universiteteve publike, në mënyrë që të përfshihen edhe studentët e universiteteve private.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: A ka mundësi ta përsëritni edhe një herë, zoti Stavilevci? Kërkoj falje, por të jeni pak më konkret: cila është ideja dhe çfarë propozoni konkretisht?

Gëzim Stavilevci: Konkretisht propozoj që numri i bursave në Komunën e Mitrovicës të jetë pa limit. Propozimi tjetër është që Rregullorja nr. 02/2020, e cila në nenin 3 përcakton që bursat jepen vetëm për studentët e fakulteteve publike, të ndryshohet në mënyrë që të përfshihen edhe studentët e fakulteteve private. Po ashtu, propozoj që në skemën e bursave të përfshihen edhe studentët e vitit të parë të studimeve master dhe të doktoraturës, si dhe të ndahet një numër i caktuar bursash për këto nivele dhe për komunitetet, ashtu siç ka qenë më herët.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Sa i përket çështjes së numrit të pakufizuar të bursave, besoj se mund ta diskutojmë kur të vijë pika e rendit të ditës, nëse aprovohet rendi i ditës. Sa i përket ndryshimit të rregullores, fillimisht duhet të procedohet me plotësim-ndryshimin e saj. Procedura për ndryshimin e një rregulloreje është e përcaktuar qartë: fillimisht duhet të dalë në diskutim publik. Pas përfundimit të diskutimit publik, rregullorja kthehet në Kuvend për miratim dhe më pas pritet vlerësimi i ligjshmërisë nga ministria përkatëse. Pra, kjo procedurë kërkon kohën e vet. Prandaj, cili është propozimi juaj konkret: inicimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për bursa?

Gëzim Stavilevci: Plotësim-ndryshimi i Rregullores për bursa mund të propozohet sot si pikë e rendit të ditës. Po ashtu, me vendim të Kuvendit mund të merret vendim që në skemën e bursave të përfshihen edhe studentët e universiteteve private, krahas atyre publike.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Një sqarim, zoti Stavilevci. Nuk mund të bëhet sot plotësim-ndryshimi i një rregulloreje, sepse procedura për hartimin dhe ndryshimin e saj është e përcaktuar me ligj. Fillimisht jepet propozimi për ndryshim, rregullorja del në diskutim publik dhe, pas përfundimit të diskutimit publik, kthehet në Kuvend për miratim. Pra, Kuvendi nuk mund ta vendosë menjëherë në rend të ditës për miratim.

Gëzim Stavilevci: Kryesues, procedurën e njohim. Sot mund të merret një vendim që bursat për vitin akademik 2025–2026 të përfshijnë studentët e universiteteve private dhe publike, si dhe studentët e studimeve master dhe doktoraturë, përfshirë edhe vitin e parë. Po ashtu, sot mund të vendosim si pikë të rendit të ditës iniciimin e procedurës për ndryshimin e Rregullores nr. 02/2020 për vitet e ardhshme. Procedura është e qartë.

Udhëheqësi i Sekretarisë, z. Nazmi Jashari: Faleminderit, kryesues. Përsëritet për të gjithë. Procedura e ndryshimit të një rregulloreje është e përcaktuar me Rregulloren për hartimin dhe publikimin e akteve të komunave. Kjo procedurë nuk mund të anashkalohet. Kuvendi i Komunës sot mund të iniciojë ndryshimin e rregullores, por nuk mund ta bëjë menjëherë ndryshimin e saj. Sa i përket çështjes që në vendim të përfshihen edhe kategori të tjera, përfshirë universitetet private, Kuvendi nuk mund të marrë vendim në kundërshtim me rregulloren që është aktualisht në fuqi. Vetëm pas ndryshimit të rregullores mund të bëhen këto ndryshime. Gjithashtu, besoj se për shpërndarjen e bursave aktuale nuk ka kohë për të pritur ndryshimin e rregullores, pasi kjo procedurë kërkon kohë.

Gëzim Stavilevci: Sa i përket procedurës, e kemi të qartë. Nuk e di nëse sekretari po propozon një ndryshim të procedurës. Megjithatë, me një vendim mund të bëhet shpallja për bursa në mënyrë që të përfshihen studentët, por në rregull, jemi dakord.

Kryetari i Komunës, z. Faton Peci: Faleminderit edhe për propozimet që i keni dhënë. Në lidhje me propozimin e fundit rreth idesë që të kemi një propozim i cili nuk është i bazuar në legjislacion dhe në rregullore, kjo nuk ka logjikë, për shkak se nuk mund të propozohet diçka që bie në kundërshtim me rregulloren. Së dyti, ne jemi të përcaktuar që çdo vendim dhe çdo shpenzim të bëhet duke zbatuar ligjshmërinë, procedurat, aspektet administrative, por edhe planifikimin buxhetor. Nuk mund të propozohet që bursat të jepen pa limit, sepse kjo nuk krijon ndjesinë e rregullit në institucion. Kuptimin e propozimit e kuptoj, sidomos nga prizmi opozitar, që ndoshta synon edhe të krijojë një përshtypje të

mirë në opinion, veçanërisht të rinjtë, duke propozuar bursa pa limit. Mirëpo në qeverisje nuk ka vendime pa limit. Çdo vendim duhet të ketë kufizimet e veta dhe çdo çështje duhet të jetë e përgatitur. Sa i përket numrit të bursave, krahasuar me vitet e tjera, ne kemi një numër më të madh bursash që do t'u jepen studentëve. Këtë vit do të ndahen 350 bursa për studentët, krahasuar me 300 sa kanë qenë vitin paraprak. Përveç rritjes së numrit të bursave, rritet edhe vlera e përkrahjes financiare: nga rreth 600 € sa ka qenë më parë, në 720 €, që përbën rreth 20% rritje të vlerës së përkrahjes për studentët tanë. Prandaj, ne e vlerësojmë çdo propozim dhe ju falënderojmë për propozimet që i keni dhënë, por nuk mund të ketë bazë për propozime që nuk kanë as arsyeshmëri financiare dhe as bazë ligjore dhe rregullative.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Kështu, sipas procedurës, Kryetari obligohet nga kërkesa e anëtarëve të Kuvendit që të nisë procedurën e plotësim-ndryshimit të Rregullores për bursa. Unë besoj se këtë procedurë Kryetari mund ta nisë më tutje, ta vendosë në diskutim publik dhe, pas përfundimit të diskutimit publik, Rregullorja do të kthehet tek ne në Kuvend për aprovim. Sa i përket këtij viti akademik, është e pamundur të përfundohet plotësim-ndryshimi i Rregullores përkohësisht. Prandaj, ne mund të themi që Kryetari fillon procedurën e plotësim-ndryshimit të Rregullores për bursa gjatë këtij viti. Në këtë mënyrë, edhe propozimet tona, përfshirë ato të zotit Stavilevci dhe të të tjerëve, marrin parasysh fillimin e plotësim-ndryshimit të Rregullores për bursa. Domethënë, në njëfarë forme, ne po e obligojmë Kryetarin që të vazhdojë procedurën e plotësim-ndryshimit gjatë këtij viti.

Fisnik Suma: Pasi kanë kaluar disa javë nga vërshimet, raporti i dëmeve ende mungon dhe nuk dihet saktë sa familje janë dëmtuar dhe sa është dëmi real. Kërkoj publikisht që të paraqitet raporti i dëmeve, të bëhet i ditur numri i familjeve të prekura dhe që secila familje të subvencionohet me nga pesë mijë euro.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Cila është kërkesa juaj, z. Suma?

Fisnik Suma: Të hidhet urgjentisht në votim, pasi kanë kaluar disa javë nga vërshimet, dhe të subvencionohen me nga pesë mijë € familjet e prekura.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Pra, kërkesa juaj, z. Suma, është që sot në rend të ditës të paraqitet ose të futet si pikë e rendit të ditës një informacion mbi situatën e vërshimeve.

Fisnik Suma: Në seancën e kaluar u tha se sot do të vinte raporti, por në fakt nuk ka ardhur.

Kryetari i Komunës, z. Faton Peci: Sipas të dhënave që kam unë, Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve ende nuk e ka përgatitur raportin përfundimtar, përkundër që kemi një raport preliminar. Në këtë kontekst, dua të sqaroj disa gjëra: qasja e propozuar nga rendi, që synon vetëm ndarjen e mjeteve financiare, duhet të ketë bazë të qartë buxhetore. Pra, është e nevojshme të specifikohet se cila është linja buxhetore që ka paraparë mbështetje për familjet potencialisht të prekura nga vërshimet. Në këtë mënyrë, çdo vendim për ndarje të mjeteve financiare duhet të marrë parasysh edhe Kodin Buxhetor dhe kufizimet ligjore dhe financiare. Buxheti nuk mund të menaxhohet vetëm mbi bazën e vullnetit pozitiv; ka limite dhe procedura që duhet të respektohen. Në parim, mund të përfshihen në informatat e përgjithshme të Kuvendit të dhëna për ecurinë dhe angazhimet e ekzekutivit lidhur me vërshimet, përfshirë aktivitetet nga niveli komunal dhe koordinimin me institucionet qendrore. Ndërsa raporti final i Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, derisa të përfundohet, mund të paraqitet vetëm si informacion preliminar dhe nuk mund të përfshijë të dhëna të plota mbi numrin e familjeve të prekura ose shumën totale të dëmit.

Igballe Islami: Meqenëse u përmend se buxheti është miratuar nga qeverisja jonë, dua të sqaroj se ne e kemi miratuar buxhetin brenda afatit të rregullt kohor. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me vërshimet e vitit 2023. Atëherë, pasi buxheti komunal ishte miratuar, me bartjen e të hyrave vetanake komunale kemi subvencionuar familjet që janë prekur drejtpërdrejt nga vërshimet në Komunën e Mitrovicës. Në atë rast, janë ndarë 500,000 € për subvencionimin e familjeve në nevojë, ku secila familje ka përfituar një ndihmë financiare prej 2,500 euro. Andaj, sot jemi në një situatë pothuajse të njëjtë: buxheti është i miratuar, ndërsa bartja e të hyrave vetanake komunale ende nuk është aprovuar. Drejtori për buxhet dhe financa, gjatë mbledhjes së ardhshme, ka edhe obligim ligjor që të bëjë bartjen e të hyrave vetanake komunale të pashpenzuara dhe një pjesë e këtyre mjeteve të ndahet për familjet që kanë pësuar dëme. Jo vetëm për

familjet, por gjithashtu do të iniciojmë ndihmën edhe për bizneset dhe kategoritë e tjera të prekura nga vërshimet. Pra, mundësitë financiare ekzistojnë; gjithçka varet nga vullneti politik.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Çështja është se kompensimi do të ketë vendim. Vlera e kompensimit do të varet nga dakordimi që do të bëjmë me Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe me Ministrinë e Financave, pasi kompensimi përmes AME-së bazohet në vlerësimin e dëmit dhe kontributin e Qeverisë.

Në këtë kontekst, dhe duke pasur parasysh mundësitë buxhetore dhe kapacitetin financiar që kemi, do t'u dalim në ndihmë familjeve të prekura. Megjithatë, nuk mund të procedojmë përcaktimin e shumës financiare pa u përgatitur raporti final i Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, sepse vendimet nuk mund të merren mbi bazën e supozimeve, hamendësimeve apo vetëm të vullnetit pozitiv.

Pra, mes vullnetit, mundësive dhe bazës ligjore, çdo vendim duhet të jetë i saktë dhe i ligjshëm. Nuk mund të përcaktohen vlerat e ndarjes së kompensimeve derisa Komisioni të përfundojë vlerësimin përfundimtar.

Valon Brahimi: Siç e dini, disa ditë më parë, në afat ligjor shtatë ose tetë ditë para mbajtjes së kësaj seance, ka ardhur një kërkesë në sekretarinë e kuvendit nga Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Kërkesa ka të bëjë me ndihmë financiare për familjen Brahimi.

Për hirë të korrektësisë, nuk janë të afërt me mua, por jam nga i njëjti vend. Familja ka pësuar një aksident për shkak të shpërthimit të një bombole gazi. Vitin e kaluar komuna ka ofruar ndihmë por familja ka nevojë për përkrahje shtesë.

Familja ka kërkuar një ndihmë minimale prej 5,000 euro, dhe kjo kërkesë ka ardhur pas një takimi që ka pasur prindi i Elion Brahimit me nënKryetarin e Komunës. Më intereson të di pse kjo kërkesë nuk është proceduar deri më tani, pa nënkuptuar që domosdoshmërisht duhej të procedohej në këtë seancë. Vetëm për informacion, dua të kuptoj pse nuk është futur si material shtesë në Kuvend, në mënyrë që të kemi mundësinë të shqyrtojmë situatën dhe të vendosim se si mund të ndihmojmë familjen në fjalë, si Kuvend dhe si Komunë.

Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi: Po, është e vërtetë se kërkesa ka ardhur në Sekretarinë e Kuvendit, dhe unë e kam përcjellë të njëjtën kërkesë te Drejtoria për Shëndetësi dhe te Kryetari i Komunës, sepse ka implikim financiar dhe duhet të kalojë nëpër filtrat e ekzekutivit. Siç dihet, Kuvendi i Komunës nuk ka buxhet të vetin për këto qellime. Kërkesa është proceduar te Drejtoria për Shëndetësi dhe te Kryetari, dhe besoj se brenda afatit ligjor do të trajtohet. Varësisht prej vendimit, mund t'i komunikohet, qoftë Kuvendit në rast nevojë për aprovim, qoftë Drejtorisë nëse ajo e sheh të arsyeshme të veprojë sipas procedurës. Nuk e kemi futur në Kuvend, sepse kemi menduar, dhe besoj se është e drejtë, që kërkesa t'i drejtohet Drejtorisë për Shëndetësi dhe Kryetarit të Komunës, të cilët realisht merret me këto raste.

Valon Brahimi: Kryesues, mendoj se kanë qenë të mjaftueshme shtatë ditë për shqyrtimin nga ekzekutivi. Mundësitë financiare ekzistojnë. Për hir të korrektësisë, unë kam diskutuar çështjen edhe me drejtorin, z. Beshiri, dhe mjetet janë në dispozicion. Kërkesa duhet të shqyrtohet përtej çdo bindjeje politike apo partiake; është një akt kryesisht moral, dhe komuna ka mundësinë dhe besoj duhet ta bëjë.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Besoj se, në raport me subvencionet, mbështetja rregullohet nga Rregullorja, e cila përcakton procedurën. Edhe sikur ekzekutivi të dëshironte të vepronte jashtë rregullores dhe mundësive të saj, nuk mund të shkojë përtej asaj që lejon procedura. Ky rast duhet trajtuar sipas rregullores që e përcakton këtë çështje.

Kryetari i Komunës, z. Faton Peci: Ka vullnet për të trajtuar një rast të tillë, dhe nuk është e nevojshme të përmenden aspekte partiake, sepse fatkeqësitë nuk lidhen me përkatësi partiake. Nuk i shoh çështje të tjera në këtë drejtim; le të trajtojmë rastet e fatkeqësisë si tërësi. Ky rast nuk është pikë e rendit të ditës, por kjo nuk do të thotë se nuk trajtohet. Duhet të kujdesemi që, brenda mundësive, ndihma të jetë sa më e madhe.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Kryetar, edhe një çështje: z. Valon Brahimi ngriti një propozim në lidhje me dy urat. Unë mendoj dhe konsideroj se nuk është një çështje që ka nevojë për ngutje.

Kryetari i Komunës, z. Faton Peci: E konsideroj se nuk është një çështje me ngut.

Valon Brahimi: Sipas nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, që shërben si bazament për të gjitha ligjet e tjera që qeverisin komunën, pika 44.1 dhe 44.2 përcaktojnë se Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë për vendimmarrjen lidhur me emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike. Interpretimi i këtij neni përfshin edhe urat, nënkalimet, bulevardet dhe sheshet. Kështu që baza ligjore është e qartë; unë kam kërkuar që çështja të vendoset në rend të ditës, dhe është çështje e vullnetit të anëtarëve të Kuvendit nëse do ta procedojnë apo jo.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Z. Brahimi, po flas bazuar në përvojën time lidhur me disa raste, të cilat na kanë ndihmuar të ruajmë konsensusin, në veçanti, është e rëndësishme të shmangim bajraktarizmin, duke thënë “unë e propozova” ose “filan grupi e propozoi”, realisht kemi qenë gjithmonë të kujdesshëm në këtë drejtim. Dua të theksoj se në të kaluarën jemi dakorduar me shefat e grupeve parlamentare për iniciativa të rëndësishme, me qëllim që të sigurojmë njëfarë konsensusi në çështje për të cilat shoqëria ka nevojë, pa u dhënë një kahje politike apo ngjyrë politike një propozimi eventual. Edhe pse çdo iniciativë mund të ketë qëllime politike, unë nuk dua ta politizoj këtë çështje. Unë e shoh këtë çështje në cilësinë time si kryesues dhe besoj se ka nevojë për një diskutim më të gjerë. Çdo subjekt duhet të kontribuojë për të gjetur një gjuhë të përbashkët dhe për të ecur më tutje, veçanërisht për propozime që janë përtej individit. Kur flitet për emra individësh ose dëshmorësh, secili mund të ndihet i stepur dhe vendoset në një pozicion të vështirë, ku duhet të kujdeset për fjalët. Prandaj, kemi nevojë për konsensus në këto çështje, që Kuvendi, veçanërisht si institucion, të dalë unik dhe të mos ketë divergjenca në lidhje me iniciativa të tilla.

Kryetari i Komunës, z. Faton Peci: Nëse ka mundësi të dëgjojmë njëri-tjetrin, unë mendoj se emërtimet individuale nuk duhet të jenë pjesë e diskutimit të seancave, dhe nuk duhet të shndërrohen në objekt përplasjeje mes të zgjedhurve të popullit. Ka shumë propozime dhe emra kredibilë që kanë kontribuar jashtëzakonisht për Mitrovicën dhe për Kosovën, dhe në mesin e tyre janë edhe dy emrat që u përmendën. Për të mos politizuar çështjen – për shembull, PDK-ja pas katër vjet qeverisjeje nuk ka propozuar asnjë emërtim për ish-kryeministrin e parë të Republikës së Kosovës, Bajram Rexhepin – unë mendoj se edhe emri i tij, si kryeministër i parë, mund të jetë pjesë e emërtimeve në qytet, sikurse edhe emri i dëshmorit që u përmend, dhe shumë të tjerëve. Megjithatë, për këtë duhet të ulemi dhe diskutojmë, sepse ka nevojë për emërtime të reja, për figura të reja të rrugëve dhe shesheve, ku duhet të arrihet një konsensus i gjerë. Çdo vendim për emërtimet e reja duhet të jetë gjithëpërfshirës, për të gjithë qytetin, dhe jo vetëm për propozime të veçanta.

Valon Brahimi: Së pari, më vjen keq që po e trajtoni këtë çështje si politike. Avni Hajredini Kushtova, që ka qenë anëtar i një subjekti politik, nuk ka pasur si prioritet përkatësinë partiake. Së dyti, Bajram Rexhepi, para se të bëhej pjesë e PDK-së, ka qenë anëtar i LDK-së. Ai ka qenë doktor i luftës, humanist dhe kryeministri i parë i Kosovës, me përkrahjen e doktor Ibrahim Rugovës, dhe ka qenë njëri prej kryetarëve të parë të kësaj komune, me një kontribut jashtëzakonisht të madh për vendin. Ky propozim duhet të shihet përtej bindjeve politike. Meqenëse po afrohet 27-vjetori i rënies së dëshmorit Avni Hajredini Kushtova, propozimi u bë për ta kujtuar atë, jo për të marrë vendim sot. Dëshira është të iniciohet procedura e emërtimit të këtyre dy lokacioneve, duke ditur që ekziston një komision brenda Drejtorisë së Urbanizmit që merret me këto çështje. Nëse ka vullnet të anëtarëve, Kuvendi mund të obligojë ekzekutivin, domethënë drejtorin përkatës, që të ndërmarrë veprimet e nevojshme. Nuk po them se vendimi duhet të miratohet sot; qëllimi është që kjo të kalojë si propozim-vendim. Kjo kërkesë ka një dimension të ndërgjegjes kombëtare, sidomos në këtë kohë kur po sulmohet sakrifica e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuk ka logjikë të heshtim përpara kësaj çështjeje. Unë jam angazhuar si

përfaqësues i qytetarëve, dhe secili prej anëtarëve është i lirë të votojë ose jo, por kërkoj që kjo çështje të mos anashkalohet nga ditët e vendosura nga Kuvendi.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Pra, ne pajtohemi që sot Kryetari të obligohet për të marrë iniciativën lidhur me këtë çështje.

Valon Brahim: Kuvendi mund të marrë vendim për ta futur këtë si pikë të rendit të ditës, për të inicuar procedurat. Me këtë vendim, drejtoritë përkatëse obligohen të ndërmarrin veprimet konkrete. Kjo është esenca, sot nuk ka nevojë të diskutojmë më tej, sepse procedura është e qartë. Propozoj që kjo të futet si pikë e rendit të ditës, jo vetëm si diskutim, por si iniciativë konkrete.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Z. Brahim, besoj se edhe ju e keni durimin e kufizuar, dhe disa mund të ndihen të befashuar nga konkretizimi i kërkesës për ta futur në rend dite. Nuk ka nevojë të zgjatet, por të hyjë konkretisht. Pra, kërkesa e zotit Brahim është që të futet si pikë e rendit të ditës iniciimi për emërtimin e dy urave mbi Lumin Ibër, emrat nuk mund të përmenden sot, por duhet të bëhet iniciimi dhe diskutimi publik, siç tha edhe z. Brahim. Rëndësi ka që sot të hyjë iniciimi.

Valon Brahim: Kryesues, me lejen tuaj, kërkoj që në procesverbal të regjistrohet kërkesa ime për emërtimin e këtyre dy figurave. Më pas, është çështje e anëtarëve të Kuvendit nëse do të votohet apo jo. Nuk po i detyroj, po propozoj për votim.

Jeton Ujkani: Përshëndetje kryetar, përshëndetje të gjithë! I kisha lutur kolegët e PDK-së që të mos na detyrojnë neve si Kuvend të votojmë. Ju e dini që nuk i keni votat; nëse na shtyni të votojmë për dëshmorët, nuk është në rregull, janë komisionet relevante të komunës që merren me këtë çështje.

Kushtrim Zeneli: Është e dukshme që opozita ka reaguar shumë vonë. Për fat të keq, gjatë katër viteve të qeverisjes nuk është kujtuar për këta, edhe pse shumica kanë qenë në ekzekutiv dhe në negociata; nuk është ngritur asnjëherë iniciativë për Bajram Rexhepin apo Avni Kushtovën. Përmendorja e Avni Kushtovës në Veri tregon se gjatë katër viteve të kaluar nuk ka pasur propozim nga qeverisja, ndërsa tani ka iniciativë nga anëtarët e Kuvendit. Pyetja është se kush e ka ndërtuar dhe administruar përmendoren aktualisht, duke theksuar se kjo është një çështje konkrete dhe duhet trajtuar me korrektësi. Sa i përket propozimit për bursat, është kërkuar që ato të jenë pa limit. Duhet sqaruar se nuk ekziston rregullore që lejon vendime pa limit; lejohet vetëm rritja e numrit të bursave dhe vlera e tyre sipas rregullores ekzistuese. Të gjitha propozimet duhet të jenë brenda kuadrit ligjor dhe buxhetor.

Pika e emërtimit të rrugëve dhe urave, propozoj që për këtë çështje të shtyhet një seancë tjetër për përgatitje më të mirë. Qëllimi është që të arrihet konsensus mbi emrat dhe që vendimi të jetë i qartë, gjithëpërfshirës dhe pa krijuar konflikte politike. Po ashtu, sa i përket raportit të kërkuar për dëmet nga vërshimet, e mirëpres iniciativën. Megjithatë, kërkoj që kur të dorëzohet raporti i vërshimeve, të na silltet edhe raporti i auditimit të brendshëm për raportin e mëparshëm të vërshimeve, që të shihet mënyra se si janë shpërndarë mjetet. Kjo sepse disa biznese në qytet nuk kanë pësuar dëme, por kanë marrë kompensime prej 10,000 deri 15,000 euro. Kërkoj që kjo të evidentohet në procesverbal.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Në këtë pikë janë paraqitur dy propozime:

Propozimi i parë – Të futet në rend të ditës inicimi i procedurës për emërtimin e dy urave mbi Lumin Ibër me emra të përveçëm të propozuar, duke obliguar ekzekutivin dhe komisionin përkatës që të ndërmarrin hapat ligjorë për procedim të mëtejshëm.

Propozimi i dytë – Çështja e emërtimit të shtyhet për një nga seancat e ardhshme, me qëllim të përgatitjes më të mirë dhe trajtimit të plotë procedural.

Valon Brahim: Në cilësinë e përfaqësuesit të qytetarëve dhe sipas kërkesës së tyre, propozoj që të futet si pikë e rendit të ditës: “Inicimi i procedurës për emërtimin e dy urave mbi Lumin Ibër me emrat e dy personaliteteve të propozuara”, Ky propozim ka për qëllim që Kuvendi përmes votimit, të obligojë ekzekutivin dhe komisionin përkatës brenda Drejtorisë kompetente që të ndërmarr hapat ligjorë për nisjen e procedurës zyrtare të emërtimit, pra procedimin e mëtejshëm sipas legjislacionit në fuqi. Vërehet se kjo është kërkesë për inicim procedure dhe jo vendim përfundimtar; votimi mbetet në ndërgjegjen e secilit anëtar të Kuvendit.

Kryetari i Komunës, z. Faton Peci: Gjatë diskutimit u theksua se përmendja e emrave të përveçëm në këtë fazë mund të konsiderohet prejjudikim i vendimit final, i cili duhet të vijë pas inicimit formal të procedurës dhe zhvillimit të konsultimeve përkatëse. Propozohet që, duke qenë se çështja lidhet me kompetencë të Kuvendit dhe ka bazë ligjore për inicim, të hidhen në votim propozimet e paraqitura dhe të vendosë Asambleja. Po ashtu, bëhet thirrje që diskutimi të zhvillohet me respekt të ndërsjellë, duke theksuar se nderimi i dëshmorëve është çështje e ndërgjegjes, përgjegjësisë dhe obligimit qytetar e kombëtar të secilit, dhe nuk duhet të bëhen vlerësime personale ndaj anëtarëve lidhur me këtë çështje.

Jeton Ujkani: Kërkoj që çështjet e emërimit të lokacioneve publike, sidomos kur lidhen me dëshmorë dhe figura me rëndësi të veçantë për qytetin dhe vendin, të mos politizohen dhe të trajtohen me maturi institucionale, në përputhje me rregulloren dhe procedurat në fuqi. Po ashtu respekti ndaj dëshmorëve dhe figurave të rëndësishme është i përbashkët për të gjithë dhe nuk duhet të vihet në dyshim ndjeshmëria e askujt në këtë drejtim.

Valon Brahimi: Sqaroi se kërkesa e tij ka qenë që çështja të futet në rend të ditës për inicim procedure, duke lënë votimin në ndërgjegjen e secilit anëtar, pa pretenduar se dikush nuk ka respekt ndaj dëshmorëve apo figurave të përmendura.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Këtu konstatoi se çështja është e qartë sa i përket propozimeve të paraqitura dhe se Asambleja do të vendosë përmes votimit sipas procedurës.

Igballe Islami: Sqaroi, se deklarata se bizneset në Komunën e Mitrovicës janë subvencionuar gjatë vërshimeve është e pavërtetë; asnjë biznes nuk ka përfituar nga buxheti komunal. Nëse ndonjë biznes ka përfituar përmes Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, kjo është çështje e veçantë dhe nuk lidhet me Komunën. Theksoi rëndësinë e dallimit mes shefit të shtabit emergjent dhe Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, pasi janë dy funksione të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Sqaroi se diskutime të tilla që bëhen pa dhënë fjalën nuk regjistrohen në procesverbal. Për këtë arsye, fjalën duhet ta japë kryesuesi për t'i mundësuar diskutimin e rregullt. Theksoi rëndësinë e respektimit të Rregullores së Kuvendit, e cila përcakton qartë kur dhe sa herë mund të flitet gjatë seancave. Për këtë seancë, u lejuan disa herë diskutime shtesë, por në të ardhmen duhet respektuar më strikt rregullorja.

Kushtrim Zeneli: Vuri në dukje se gjatë katër viteve të fundit mund të shihet nga procesverbalet dhe seancat se sa herë kanë ngritur zërin si grup parlamentar dhe individualisht. Sidoqoftë, theksoi shqetësimin më të madh: pranimin e gënjeshtreve për financimin e bizneseve nga z. Islami. Shpjegoi se disa biznese mund të jenë subvencionuar nga ministrinë përkatëse përmes thirrjeve publike, por kjo nuk ka të bëjë me Komunën, dhe shumë informacione të raportuara janë të pasakta.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi Prezantoi propozimet e paraqitura dhe sqaroi se i pari është nga z. Fisnik Suma, që të ketë një informatë mbi gjendjen e vërshimeve të fundit. Pyeti z. Suma nëse dëshiron që të presim raportin përfundimtar nga drejtoria përgjegjëse dhe ta diskutojmë në seancën e ardhshme, apo dëshiron që sot të merret një informacion i pjesshëm nga ekzekutivi. Vuri në dukje se një informacion i tillë mund të jetë i mangët dhe nuk do të lejonte diskutim të plotë mbi çështjen.

Fisnik Suma: Shpreh qëndrimin tim për të pritur raportin, mirëpo kërkoj që ai të prezantohet në seancën e ardhshme, duke u bazuar edhe në premtimin e bërë në seancën e kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Theksoi se, sapo ekzekutivi harton raportin mbi gjendjen e dëmeve, ka obligim ligjor që ta paraqesë dhe ta prezantojë për aprovim në Kuvendin e radhës. Kjo procedurë është e detyrueshme dhe nuk mund të shmanget.

Kryetari i Komunës, z. Faton Peci: Kërkoj nga komisioni përkatës që, brenda mundësive, të përgatisë raportin dhe ta sjellë në seancën e ardhshme. Sqaroi se, në rast se puna është voluminoze dhe nuk mund të përfundohet brenda afatit, nuk mund t'u kërkojë të përfundojnë patjetër vetëm për shkak të seancës. Theksoi interesimin e tij personal për të parë detajet e plota të raportit sa më shpejt të jetë e mundur.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi: Konstatoi që z. Fisnik Suma tërhiqet nga propozimi i tij për informim mbi gjendjen e vërshimeve. Pyes z. Valon Brahimi nëse pajtohet që të propozohet si pikë e rendit të ditës inicimi i procedurës për emërtimin e dy urave mbi Lumin Ibër, duke lënë diskutimin për emrat për fazën kur çështja të vijë në rend të ditës.

Valon Brahimi: Propozimi im është inicimi i procedurës për emërtimin e dy urave. Kërkoj që në procesverbal të shënohet çështja me emrat e propozuar: Bajram Rexhepi dhe Avni Koshtova. Theksoj se, nëse gjatë procedurës Kuvendi vendos për emra të tjerë, ai nuk ka asnjë kundërshtim dhe do të votojë pa problem për çdo propozim tjetër të Kuvendit.

Kryesuesi Meqenëse nuk ka diskutime tjera, hedh në votim propozimin që të hyjë si pikë e 20 e rendit të ditës Inicimi i emërtimit të dy urave mbi lumin Ibër me emra të përveçëm, të cilët u propozuan nga z. Valon Brahimi, sqarim: ata që nuk e kanë dhënë betimin nuk kanë të drejtë vote.

Rezultati i votimit: 16 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstaton se propozimi u miratua.

Kryesuesi hedh në votim rendin e ditës të plotësuar ai në vijim:

1. Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Propozim vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve
4. Propozim vendim për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026
5. Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
6. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
7. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
8. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik
9. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit
10. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
11. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore
12. Propozim vendim për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026
13. Propozim vendim Për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave
14. Propozim vendim Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Uniteti"
15. Propozim vendim Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunkionale"
16. Propozim vendim Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"- SH.A.
17. Propozim vendim Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu"
18. Propozim vendim Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve
19. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025
20. Inicimi i emërtimit të dy urave mbi lumin Ibër me emrat Bajram Rexhepi dhe Avni Koshtova

**Rezultati i votimit: 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se Kuvendi i Komunës unanimisht miratoi rendin e ditës, të plotësuar.**

## Pika 1

Kryesuesi i ftoj subjektet më të mëdha politike të përfaqësuara në Kuvend që të propozojnë nga një anëtar për Formimin e Komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të rinj të Kuvendit.

Shkëlqim Ibrahimimi nga radhët e PDK-së e propozoi z. Egzon Hamza.

Kushtrim Zenelin nga radhët e VV-së e propozoi znj. Erseka Barani

Olti Ahmeti nga radhët e LDK-së e propozoi znj. Arta Neziri.

**Kryesuesii kuvendit konstatoi se Kuvendit unanimitisht miratoi vendimin per formimin e komisionit për verifikimin e mandateve dhe përbërjen e tij, dhe ftoi komisionin te bej verifikimin e mandateve të anëtarëve të rinj të Kuvendit**

Pas verifikimit të mandateve nga ana e Komisionit për verifikimin e mandateve, Kryesuesi ftoi anëtarët e Kuvendit ta japin Betimin,

z. Lavdim Zeneli.

*Unë, Lavdim Zeneli, betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.*

**(Duartrokitje)**

Kryesuesi ftoi anëtarin e ri të Kuvendit z. Bajram Istrefi.

*Unë, Bajram Istrefi, betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.*

**(Duartrokitje)**

Kryesuesi ftoi anëtaren e re të Kuvendit znj. Rozana Peci

*Unë, Rozana Peci, betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtare e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.*

**(Duartrokitje)**

## Pika 2

Kryesesi hap diskutimin për dy procesverbalet nga mbledhjet e kaluara.

Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim i hedh në votim procesverbalet nga mbledhjet e kaluara.

**Rezultati i votimit: 31 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesesi konstatoi se dy procesverbalet nga mbledhjet e kaluara të Kuvendit u miratuan unanimitisht.**

## Pika 3

Kryesuesi hap diskutimin lidhur me Propozim vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nëse ka dikush ndonjë sugjerim apo propozim tjetër.

Kryesuesi: Pasi konstatoi se nuk ka të lajmëruar për diskutim hodhi në votim Propozim vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, sikurse është propozuar në propozim vendim.

**Rezultati i votimit: 31 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi e konstatoi të miratuar Vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.**

**Pika 4**

Sa i përket Propozim vendimit për formimin e Grupit Punues Për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2026, në takim me shefat e grupeve parlamentare, u dakordua që përbërja e grupit punues të përfshijë nga një përfaqësues nga secili subjekt politik, si dhe përfaqësues të tri partive me anëtarë në Kuvend. Atëherë kërkohet nga secila parti të jep emërin e të propozuarit që do ta përfaqësojë partinë e vetë, atëherë fillojmë me GP të PDK-së:

Shkëlqim Ibrahim: GP i PDK-së propozoj: znj. Igballe Islami.

Kushtrim Zeneli: GP i LVV-së propozoj z. Armend Begu.

Visar Sylja: GP i GUXO-së propozoj znj. Elfate Ademi Bahtiri.

Oltion Ahmeti: GP i LDK-së propozoj znj. Xhuljeta Imeri

Kryesuesi Safet Kamberi: Për anëtarë të GP-së nga radhët e FD-së propozoj z. Jeton Ujkani, nga AKR-ja propozoj z. Gjergj Beka dhe nga NISMA-së propozoj znj. Flamur Vojvoda.

Kryesuesi hedh në votim propozimin Për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2026, në përbërje:

1. Armend Begu
2. Igballe Islami
3. Elfate Ademi Bahtiri
4. Xhuljeta Imeri
5. Gjergj Beka
6. Jeton Ujkani, dhe
7. Flamur Vojvoda

**Rezultati i votimit: 31 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi konstatoj se u miratua unanimisht Vendimi për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2026.**

**Pika 5**

Kryesuesi, Safet Kamberi, njofton se sa i përket propozim-vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, fjalën ia kalon Kryetarit të Komunës, z. Faton Peci.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Të nderuar anëtarë të Kuvendit, duke u bazuar në: Nenin 12, paragrafi 2, pika 2 dhe 58 pika h të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1, pika 4 dhe Nenin 77, paragrafi 1, pika 10 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Nenin 7 të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë; Nenin 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për Këshillat Komunalë për Sigurinë në Bashkësi, sot propozoj themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB). Kuvendi i Komunës së Mitrovicës propozon dhe miraton themelimin e KKSB-së. Ky këshill është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi, me përfaqësim të gjerë nga të gjitha komunitetet në komunë, nga shoqëria civile dhe institucionet relevante. Këshilli ka detyrën të propozojë, monitorojë dhe koordinojë masat për siguri në bashkësi, si dhe të kontribuojë në rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional.

Përbërja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi:

1. Kryetari i Komunës – kryesues i Këshillit
2. Komandanti i Stacionit të Policisë
3. Një përfaqësues legjitim nga secila bashkësi fetare
4. Një përfaqësues nga secili komunitet etnik në komunë
5. Kryesuesi i Komitetit të Kuvendit të Komunës

6. Zyrtari për Barazi Gjinore – propozuar: Besa Veseli
7. Drejtori për Arsim – Shefki Begu
8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Komunë
9. Një përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)
10. Një përfaqësues nga secili Këshill Lokal për Siguri në Bashkësi
11. Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
12. Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave të Gjendjes Civile Komunale
13. Një përfaqësues nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – propozuar: Enes Kaçapori
14. Një përfaqësues nga organizatat joqeveritare
15. Një përfaqësues nga media lokale
16. Një përfaqësues nga Komiteti i Bizneseve
17. Një përfaqësues nga Komiteti i Personave me Aftësi të Kufizuara – propozuar: Oktaj Hasani

Kryesuesi Safet Kamberi: Atëherë, hedh në votim propozim vendimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi me përbërjen e komisionit të propozuar nga Kryetari i Komunës z.Faton Peci si në vijim:.

1. Faton Peci - Kryetar i Komunës dhe Kryesues i Këshillit,
2. Komandanti i Stacionit të Policisë;
3. Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës.
4. Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të komunës;
5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës;
6. Besa Veseli - Zyrtare për Barazi Gjinore;
7. Shefki Begu - Drejtor i Drejtorisë për Arsim;
8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Komunës;
9. Një përfaqësues i FSK-së;
10. Një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike;
11. Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;
12. Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale;
13. Enes Kaçapor - Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim;
14. Oktaj Hasani përfaqësues nga OJQ-të
15. Përfaqësues nga mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

**Rezultati i votimit: 31 për, 0-kundër, 0-abstenime.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua me votë unanime Vendimi për themelimin e Këshillit komunal për siguri në bashkësi.**

### **Pika 6**

Kryesuesi: Atëherë, kalojmë te propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Domethënë, ne patëm një takim edhe me shefat e grupeve parlamentare. Janë gjithsej gjashtë komitete, secili prej tyre me pesë anëtarë. Tre prej tyre do të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe dy nga jashtë. Kështu, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të Kuvendit do të jenë pjesë e këtyre komiteteve, duke respektuar faktin se pjesëtarët e dy komiteteve të përhershme (Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete) nuk mund të jenë pjesë e këtyre komiteteve të tjera. Çdo anëtar i Kuvendit do të ketë pjesëmarrje në një nga këto komitete. Nëse keni propozime konkrete për secilën pikë, mund t'i japim tani dhe më pas t'i aprovojmë secilin komitet veç e veç. Po ashtu, një sqarim: anëtarët e komiteteve të përhershme (Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete) nuk kanë të

drejtë të jenë pjesë e këtyre komiteteve të tjera. Tani vazhdojmë me procesin për secilin komitet tjetër sipas rendit të ditës.

Në vazhdim Kryesuesi kërkoi nga subjektet politike që të propozojnë anëtarët e tyre për KSHAMS,

Shkëlqim Ibrahim: GP i PDK-ja propozon z. Lavdim Zenelin

Kushtrim Zeneli: GP i LVV propozon nga jasht znj. Nerxhivane Sadiku

Visar Sylja: GP i GUXO-ja propozon z. Rozana Peci

Oltion Ahmeti GP i LDK –së propozon nga jasht z. Besfort Xhemajli

Kushtrim Zeneli: GP i LVV propozon z. Jeton Zeneli

Hedh në votim propozim vendimin përformimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në përbërje:

1. Lavdim Zeneli, (anëtar i Kuvendit)
2. Jeton Zeneli, (anëtar i Kuvendit)
3. Rozana Peci, (anëtare e Kuvendit)
4. Nerxhivane Sadiku, dhe
5. Besfort Xhemajli.

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 30) 30 për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**

#### **Pika 7**

Në vazhdim Kryesuesi kërkoi nga subjektet politike që të propozojnë anëtarët e tyre për Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Shkëlqim Ibrahim: GP i PDK-ja propozon z. Gëzim Stavilevci dhe Nazmije Sejdiqaj

Kushtrim Zeneli: GP i LVV propozon znj. Rinesa Preteni

Visar Sylja: GP i GUXO-së propozon znj. Fjolla Habibaj

Kushtrim Zeneli GP i LVV propozon nga jasht znj. Qefsere Barku

Kryesuesi Safet Kamberi: Hedh në votim propozim vendimin për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në përbërje:

1. Gëzim Stavilevci, (anëtar i Kuvendit)
2. Rinesa Preteni. (anëtare e Kuvendit)
3. Nazmije Sejdiu, (anëtare e Kuvendit)
4. Fjolla Habibaj, dhe
5. Qefsere Barku

**Rezultati i votimit: 31-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstatoi se miratohet unanimisht Vendimi për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.**

#### **Pika 8**

Në vazhdim Kryesuesi kërkoi nga subjektet politike që të propozojnë anëtarët e tyre për Komitetin për Zhvillim Ekonomik.

Shkëlqim Ibrahim: GP i PDK-së propozon znj. Liridona Muharremi dhe z. Egzon Sadiku

Kushtrim Zeneli: GP i LVV propozon z. Sazan Ramaxhiku

Visar Sylja: GP i GUXO propozon nga jasht z. Ilir Parduzi

Oltion Ahmeti: GP i LDK-ja propozon z. Xhevdet Ferizi

Kryesuesi: Hedh në votim propozim vendimin për formimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik me këtë përbërje:

1. Liridona Muharremi, (anëtar i Kuvendit),
2. Egzon Sadiku, (anëtar i Kuvendit),

3. Sazan Ramaxhiku (anëtar i Kuvendit),
4. Ilir Parduzi, dhe
5. Xhevdet Ferizi

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 30) 30-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

Kryesuesi konstatoi se miratohet unanimsht Vendimi për formimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.

#### **Pika 9**

Kryesuesi kërkoi nga subjektet politike që të propozojnë anëtarët e tyre për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit.

Shkëlqim Ibrahim: Për anëtare të GP-së nga radhët e PDK-së propozoj z.Artan Berisha dhe z. Ferdi Kadriu,

Kushtrim Zeneli: GPi LVV propozon z. Bajram Istrefi

Visar Sylja: GP i GUXO propozon nga jasht znj. Blerta Çeliku

Oltion Ahmeti: GP i LDK-së propozon nga jasht znj.Arisa Miftari

Kryesuesi: konstatoj se 30 anëtar jan të pranishëm në mbledhje, Hedh në votim Propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit me këtë përbërje:

1. Ferdi Kadriu (anëtar i Kuvendit),
2. Artan Berisha, (anëtar i Kuvendit
3. Bajram Istrefi (anëtar i Kuvendit),
4. Blerta Çeliku, dhe
5. Arisa Miftari.

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 30) 30-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton, miratohet unanimsht Vendimi për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit.**

#### **Pika 10**

Në vazhdim Kryesuesi kërkoi nga subjektet politike që të propozojnë anëtarët e tyre për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Shkëlqim Ibrahim: GP i PDK-së propozon z. Egzon Hamza dhe znj.Mihrije Rexha Haziri

Kushtrim Zeneli: GP i LVV propozon nga jasht z. Adelina Brahimi.

Visar Sylja: GP i GUXO propozon nga jasht z. Xhevdet Osmani

Kryesuesi: Hedh në votim Propozim vendimin për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim me këtë përbërje:

1. Egzon Hamza
2. Oltion Ahmeti,
3. Xhevdet Osmani,
4. Mihrije Rexha Haziri, dhe
5. Adelina Brahimi.

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 30) 30-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet unanimsht Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.**

#### **Pika 11**

Në vazhdim Kryesuesi kërkoi nga subjektet politike që të propozojnë anëtarët e tyre për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore.

Shkëlqim Ibrahim: GP i PDK-së propozon Shkëlqim Ibrahim dhe z. Ylli Veliu

Kushtrim Zeneli: GP i LVV-së propozon znj. Festina Musliu

Visar Sylja: GUXO-ja propozon z. Elfate Ademi Bahtiri

Oltion Ahmeti: GP i LDK-së propozon znj. Arta Neziri

Kryesuesi: Hedh në votim Propozim-vendim për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore me këtë përbërje:

1. Arta Neziri
2. Shkelqim Ibrahim
3. Elfate Ademi Bahtiri,
4. Ylli Veliu, dhe
5. Festina Musliu

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 31) 31-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet unanimisht Vendimi për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore.**

Kryesuesi theksoi se, me kërkesë të nënKryetarit të komunës dhe një pjese të anëtarëve të Kuvendit, të shkohet në pauzë deri në orën 14:00 për shkak të vizitës së një delegacioni. Pra, është mirë që t'i mirëkuptojmë.

**Pauzë 12:35**

**Fillon 14:15**

Kryesuesi: Konstatohet setë pranishëm janë 31 anëtarë.

### **Pika 12**

Kryesuesi sa i përket Shpalljes së konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026, fjalën ia kalon NënKryetarit të Komunës z. Enis Osmani.

NënKryetari i Komunës z. Enis Osmani: Të nderuar anëtarë, të nderuar të pranishëm dhe anëtarë të ekzekutivit, për këtë vit e kemi paraparë të rrisim numrin e bursave nga 300, sa kanë qenë në vitin 2025, në 350, edhe shumën nga 630 € në 720 € Domethënë, ky është propozimi ynë për këtë vit, ndërsa për vitin e ardhshëm do ta shohim shqyrtojmë dhe do ta rregullojmë përsëri.

Igballe Islami: Fillimisht, normal që e vlerësoj si propozim rritjen e bursës nga 630 € në 720 € sepse kjo është e rregulluar edhe me Rregulloren Komonale për ndarjen e subvencioneve dhe bursave, duke e pasur parasysh edhe inflacionin që është. Mirëpo, fillimisht dua të pyes edhe drejtorin e Financave lidhur me disponueshmërinë financiare sa i përket këtyre bursave. Sa është buxheti i paraparë për bursa dhe si mendoni ta mbuloni pjesën tjetër, sepse unë e di që nuk janë të mjaftueshme për 350 bursa. Me bartjen e të hyrave mund të plotësohen, mirëpo nëse veçse ka për të kaluar një vendim këtu për bartjen e të hyrave për plotësimin e shumës së nevojshme për ndarjen e bursave, unë propozoj që nga 350 bursa të bëhen 400 bursa për studentët e Mitrovicës, sepse gjatë vitit të kaluar, 2024-2025, kanë qenë 360 aplikues për bursa. Unë konsideroj që numri i studentëve veç është rritur dhe do të ketë më shumë aplikues, dhe t'u mundësojmë të gjithë studentëve të cilët e meritojnë bursën të përfitojnë. Kështu që, nga treqind e pesëdhjetë bursa të jenë katërqind bursa.

NënKryetari i Komunës, z. Enis Osmani: Buxheti për këtë vit për bursa prej 720 € është 252,000 € 180,000 € janë të buxhetuara, ndërsa pjesa tjetër ose nga të hyrat vetanake, ose mund të bartet nga ndonjë kategori tjetër.

Igballe Islami: Në rregull, normalisht që ajo drejtori prej së cilës merren ato mjete do të mbetet në vështirësi, kështu që kjo duhet të bëhet me bartjen e të hyrave. Edhe propozimi ynë është që nga 350 të bëhen 400 bursa, në mënyrë që të përfitojnë të gjithë aplikuesit.

Valon Brahim: Nën kryetar. a e keni pasur parasysh që shkalla e inflacionit është rritur dhe që në vitet e fundit shpenzimet e transportit janë shtrenjtuar? A vlerësoni që kjo rritje e shumës prej 90 € është e mjaftueshme, duke pasur parasysh rrethanat? Duhet ta kemi parasysh që rreth 40 % është shkalla e inflacionit për produktet bazë, pa i përmendur të tjerat. Mendoj që do të duhej të rritej më shumë. Nuk e di tani sa lejon rregullativa, por kjo rritje është shumë sipërfaqësore.

Nën Kryetari i Komunës, z. Enis Osmani: Në vitin 2025 bursa ka qenë 630 € Për këtë vit kemi paraparë një rritje prej 90 € Besoj që nuk është e mjaftueshme, mirëpo në bazë të mundësive që i kemi dhe duke e ditur që buxheti është aprovuar nga qeverisja e kaluar, nga ju konkretisht, për këtë vit kemi paraparë 90 € rritje. A është e mjaftueshme? Nuk është. A duhet të bëjmë më shumë? Duhet të bëjmë më shumë. Nga 630 € që ka qenë, tash është 720 €, domethënë rritja është 90 € Nuk është e mjaftueshme, por në vitet tjera do ta shohim mundësinë që të rritet edhe më shumë.

Gëzim Stavileci: Propozoj që në numrin e bursave të rezervohen 10 vende për komunitete, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e përfaqësuesve të tyre dhe të garantohet një shpërndarje më e drejtë e mundësive për të gjithë aplikuesit.

Kryeuesi i kuvendit z. Safet Kamberi: Atëherë, propozimi i ekzekutivit është ky: 350 bursa, prej tyre 720 € për vit, që i bie 80 € për muaj, ndërsa 10 bursa shkojnë për komunitete. Para se të kalojmë te kjo, duhet ta bëj edhe përbërjen, meqenëse përbërja e Komisionit për Vlerësim është pjesë e vendimit. Në takimin me shefat e grupeve parlamentare jemi pajtuar që të jetë nga një përfaqësues nga PDK, një nga LDK, një nga Vetëvendosje dhe dy nga ekzekutivi.

Shkëlqim Ibrahim: GP i PDK-së propozon znj. Liridona Muharremi

Kushtrim Zeneli: GP i LVV-së propozon znj. Rinesa Preteni

Xhyljeta Imeri: GP i LDK-së propozon z. Oltion Ahmeti

Enis Osmani: Nga ekzekutivi propozoj z. Shefki Begu, dhe z. Gazmend Gjoshë.

Kryesuesi: Hedh në votim vendimin për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026 me këtë përbërje:

1. Liridona Muharremi
2. Rinesa Preteni
3. Oltion Ahmeti
4. Shefki Begu
5. Gazmend Gjoshë

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 31) 28-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet Vendimi për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026.**

### **Pika 13**

Kryesuesi sa i përket formimit të Komisionit për Ankesa për Ndarjen e Bursave edhe këtu, në takimin me grupet parlamentare, jemi pajtuar që një anëtar të jetë nga PDK, një nga LVV dhe dy nga ekzekutivi, si dhe një përfaqësues nga shoqëria civile.

Shkëlqim Ibrahim: GP i PDK-së propozon znj. Nazmije Sejdiu

Kushtrim Zeneli: GP i LVV-së propozon z. Bajram Istrefi

Kushtrim Zeneli: GP i LVV nga shoqëria civile propozon z. Edin Lahu

Nën Kryetari i Komunës z. Enis Osmani: Atëherë, prej ekzekutivit propozojmë z. Alban Fejzullahu dhe znj. Albana Kastrati Rama.

Kryesuesi: Hedh në votim vendim për formimin e Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave me këtë përbërje:

1. Nazmije Sejdiu,
2. Bajram Istrefi,

3. Alban Fejzullahu,
4. Albana Kastrati Rama, dhe
5. Edin Lahu (nga shoqëria civile).

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 30) 30-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet Vendimi Për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave.**

#### **Pika 14**

Kryesuesi thekson se, në takimin që kemi pasur me grupet, në të vërtetë me shefat e grupeve parlamentare ata janë dakorduar për përbërjen. Besoj që ju kanë informuar edhe juve për këtë. Domethënë, ne po diskutojmë për të gjitha ndërmarrjet dhe në fund i votojmë veç e veç. Nëse nuk pajtoheni, atëherë ata janë dakorduar që në tri ndërmarrje të jenë të përfaqësuar nga Partia Demokratike, në një nga LDK-ja, ndërsa në pjesën tjetër të jenë Vetëvendosje me Guxo dhe partitë tjera. Mirëpo partitë tjera, edhe pse kanë nga një anëtar të përfaqësuar në Kuvend, kanë hequr dorë. Kjo ka qenë një lloj pajtueshmërie që grupet e partive e kanë pasur në atë takim. Megjithatë, sido që të jetë vendimi, ai mbetet në kompetencë të Kuvendit.

Xhyljeta Imeri: Përshëndetje, i nderuar kryesues, i nderuar nënkryetar, kabinet, kolegë asamblistë dhe të gjithë të pranishmit. Unë dua të bëj vetëm një thirrje, një diskutim të shkurtër lidhur me ndërmarrjet publike, pasi besoj se është në interesin e të gjithëve. Ndërmarrjet publike janë shumë të rëndësishme, duke marrë parasysh interesimin e lartë të subjekteve politike për të vendosur se kush do t'i udhëheqë dhe cila ndërmarrje gjeneron më shumë vende pune. Megjithatë, mendoj se është shumë më e rëndësishme që anëtarët që do të zgjidhen në këto ndërmarrje publike të kryejnë punën me përgjegjësi të lartë. Ju lutem që secili që do të zgjidhet në këto borde ta marrë këtë përgjegjësi seriozisht. Mos i politizoni bordet. Zgjidhni njerëzit sipas meritokracisë, jo sipas përkatësisë politike, sepse qytetarët e tjerë gjithashtu duhet të vlerësohen sipas meritave. Gjithashtu, kërkoj që të punoni dhe të veproni drejt, pa lista të gatshme, por me drejtësi dhe përkushtim ndaj interesit publik. Ju lutem, kini konsideratë edhe për qytetarët e tjerë dhe mos t'ua humbim shpresën se vetëm ata që i takojnë një partie politike mund të përzgjidhen aty.

Kryesuesi Atëherë, propozimet të cilat janë dhënë nga shefat e grupeve parlamentare janë: Jeton Zeneli nga Vetëvendosje dhe Ferdit Kadriu nga PDK ndërsa nga ekzekutivi është Arjeta Beqiri-Hyseni. A ka propozime të tjera, nëse jo atëherë e hedh në votim vendim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit Komunal të aksionarëve të KRM "Uniteti" me këtë përbërje:

1. Jeton Zeneli,
2. Ferdi Kadriu, dhe
3. Arijeta Beqiri Hyseni (E emëruar nga Kryetari i Komunës).

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 30) 30-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet Vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Uniteti".**

#### **Pika 15**

Kryesuesi sa i përket Propozim vendimit Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunkionale", sipas dakordësisë paraprake të grupeve parlamentare dhe ekzekutivit, propozimet janë: Oltion Ahmeti – përfaqësues i GP të LDK-së Sazan Ramaxhiku – përfaqësues i GP të LVV dhe Gazmend Asllani – përfaqësues i ekzekutivit

A ka propozime tjera nëse jo atëherë e hedh në votim vendimin Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunkionale" me këtë përbërje:

1. Oltion Ahmeti,
2. Sazan Ramaxhiku, dhe

3. Gazmend Asllani (I emëruar nga Kryetari i Komunës).

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 30) 28-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet unanimisht Vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunkionale".**

#### **Pika 16**

Kryesuesi ndërsa tek Propozim vendimi Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"- SH.A. propozimet janë Artan Berisha - përfaqësues i GP të PDK-së, Erseka Barani nga GP të LVV-së dhe Mujë Igrishta - përfaqësues i ekzekutivit

A ka propzime tjera nëse jo atëherë e hedh në votim vendimin Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"- SH.A. me këtë përbërje:

1. Artan Berisha
2. Erseka Hasani Barani dhe
3. Mujë Igrishta(I emëruar nga Kryetari i Komunës)

**Rezultati i votimit: 31-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet unanimisht Vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"- SH.A.**

#### **Pika 17**

Kryesuesi Propozim-vendim për formimin e Komisionit të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike "Tregu" propzimet janë: Shkëlqim Ibrahimimi - përfaqësues i GP të PDK-së, Elfate Ademi Bahtiri - përfaqësues i GP të GUXO dhe Nazmi Kelmendi - përfaqësues i ekzekutivit.

Kryesuesi: A ka propzime tjera nëse jo atëherë e hedh në votim vendimin Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu" me këtë përbërje:

1. Shkëlqim Ibrahimimi,
2. Elfate Ademi Bahtiri, dhe
3. Nazmi Kelmendi (i emëruar nga Kryetari i Komunës).

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 30) 30-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet unanimisht Vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu".**

#### **Pika 18**

Propozim-vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve. Jemi pajtuar që ky komision të ketë këtë përbërje Gëzim Stavileci – nga GP të PDK-së, Armend Begu – nga GP të LVV-së, Flamur Vojvoda – nga NISMA, Fitore Mehmeti-Behrami dhe Albina Kastrati Rama nga ekzekutivi.

Kryesuesi: A ka propzime të tjera? Nëse jo, atëherë e hedh në votim vendimin për formimin e Komisionit Komunal për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve me këtë përbërje.

1. Gëzim Stavileci,
2. Armend Begu,
3. Flamur Vojvoda,
4. Fitore Mehmeti Behrami, dhe
5. Albina Kastrati Rama

**Rezultati i votimit: 31-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet unanimisht Vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.**

## Pika 19

Kryesuesi, sa i përket Raportit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025, e hap për diskutim. Nëse nuk ka të lajmëruar, atëherë e hedh në votim Raportin e punës së Kuvendit për vitin 2025.

**Rezultati i votimit: 31-për, 0-kundër, 0-abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se miratohet unanimisht Raporti i punës së kuvendit për vitin 2025.**

## Pika 20

Kryesuesi: Kjo është iniciativa për emërtimin e dy urave mbi Lumin Ibër. Pyetja që parashtrohet është nëse pajtohemi që të votojmë konkluzionin që obligon Kryetarin e Komunës të ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë të nevojshëm për emërtimin e këtyre dy urave. Procedura duhet të fillojë nga themelimi i komisionit të posaçëm, i cili ka përgjegjësi të trajtojë të gjitha çështjet lidhur me diskutimet publike dhe çdo aspekt tjetër të nevojshëm për realizimin e procesit. Pas përfundimit të punës së komisionit, rezultatet dhe rekomandimet do të kthehen në Kuvend për shqyrtim dhe miratim përfundimtar. Në mënyrë të sinqertë, nuk është e qartë saktësisht se si do të zhvillohet çdo hap i procedurës, por është e domosdoshme që Kryetari të jetë i obliguar të vazhdojë me të gjitha veprimet ligjore të nevojshme. Pra, nëse nuk ka diskutime të tjera rreth kësaj çështjeje, pyetja është: kush është për miratimin e këtij konkluzioni? Në këtë mënyrë, Kryetari i Komunës do të obligohet që të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për zbatimin e procedurës së emërtimit të dy urave mbi Lumin Ibër.

Valon Brahim: Unë qëndroj pas propozimit tim të mëparshëm dhe kërkoj që e gjithë procedura të zhvillohet në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi, kjo është e domosdoshme dhe absolute; nuk ka rrugë tjetër që të veprohet jashtë kornizës ligjore.

Kushtrim Zeneli: Pra, unë e pata një propozim. Nuk jemi kundër diskutimit, mirëpo kërkojmë që kjo çështje, e cila është delikate dhe shumë e rëndësishme, të trajtohet në një nga seancat e ardhshme. Propozimi im konkret është që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim në një seancë të ardhshme. Ne pajtohemi me këtë qasje, mirëpo theksohet se duhet të përgatiten materialet përkatëse dhe që të veprohet në përputhje të plotë me rregulloren në fuqi, në mënyrë që procesi të zhvillohet korrekt dhe ligjërisht i saktë.

Kryesuesi: Pra, unë po parashtroj një propozim, nuk jemi kundër diskutimit, mirëpo kërkojmë që kjo çështje, e cila është delikate dhe shumë e rëndësishme, të trajtohet në një nga seancat e ardhshme. Propozimi im konkret është që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim në një seancë të ardhshme. Ne pajtohemi me këtë qasje, mirëpo theksohet se materialet përkatëse duhet të përgatiten paraprakisht dhe gjithçka të veprohet në përputhje të plotë me rregulloren në fuqi, në mënyrë që procesi të zhvillohet në mënyrë korrekte dhe ligjërisht të saktë.

Nenkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Me gjithë respektin për kolegun, unë dua ta kisha mirëkuptimin tuaj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, qoftë në fund të këtij muaji, qoftë në muajin tjetër, dhe të diskutohet aty, pa u futur në procedura të ngutshme. Unë jam i njohur me procedurën dhe çdo aspekt tjetër të saj, mirëpo do të kisha dëshiruar që gjithçka të dokumentohej dhe të bëhej me dakordësinë tuaj paraprake, për këtë arsye, ju siguroj se iniciativa ka përkrahjen tonë të plotë.

Valon Brahim: Kërkoj që kërkesa të trajtohet saktësisht ashtu siç është paraqitur në propozim dhe që materiali i ofruar tek Sekretaria e Kuvendit të shpërndahet te të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe te ekzekutivi, në mënyrë që secili të ketë mundësinë ta shqyrtojë në mënyrë të plotë dhe transparente. Kjo siguron që procesi të jetë i qartë, korrekt dhe në përputhje me rregulloren dhe ligjin në fuqi. Ndërsa sa i përket votimit është qeshtë e kuvendit se si vepron.

Kryesuesi: Tërhiqe pikën dhe lere për seancën e radhës le të iniciohet propozimi i Nenkryetarit për hapat e mëtejshëm, formohet komisioni i cili më pas do të paraqesë një raport të detajuar për vlerësim ligjor. Kjo do të thotë se Kryetari i Komunës duhet të udhëzohet nga Kuvendi që të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për zbatimin e procedurës, ndërsa komisioni kryen punën e vet sipas kompetencave. Ky

është hapi që mund të ndërmarrim si anëtarë të Kuvendit sot, duke siguruar që gjithçka të bëhet në mënyrë ligjore dhe transparente.

Shkëlqim Ibrahim: Ky është një propozim i mirëfilltë dhe përfaqëson të gjithë grupin tonë. Unë kërkoj të mbahet një pauzë e shkurtër për konsultime të brendshme, por theksoj se qëllimi ynë është që të respektohet propozimi i bërë nga anëtari i grupit tonë dhe të vazhdohet me trajtimin e tij sipas mënyrës se si është paraqitur, pa ndryshuar asnjë element të propozimit.

Kryesuesi jep 5 min pauze me kërkesë të GP të PDK-së.

Mbledhja vazhdon pas 6 Minutave

Shkëlqim Ibrahim e faleminderon Kryesuesin për mundësin e pauzes dhe e thekson se ata qëndrojnë pas propozimit të tyre dhe kërkojnë që ai të trajtohet saktësisht ashtu siç është paraqitur në fillim të mbledhjes, pa asnjë ndryshim apo modifikim.

Kryesuesi i mbledhjes thekson se aktualisht kemi dy propozime: një propozim nga Grupi Parlamentar i LVV-së dhe ekzekutivi, që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e ardhshme, dhe një propozim nga Grupi Parlamentar i PDK-së, që pika të hidhet në votim ashtu siç është propozuar nga z. Brahimi. Po ashtu konstaton se ne sill janë 31 anëtar të pranishëm

Kryesuesi Tani hedhim në votim propozimin që kjo pikë të shtyhet dhe të shqyrtohet në një nga seancat e ardhshme të Kuvendi

**Rezultati i votimit: 16-për, 0-kundër, 0 -abstenime.**

**Kryesuesi konstaton se me shumicë votash miratohet propozimi që pika të shtyhet dhe të shqyrtohet në një nga seancat e ardhshme të kuvendit të komunës..**

Kryesuesi i Kuvendit i mbylli punimet e mbledhjes së 4-të të rregulltë të Kuvendit të Komunës në ora 15:15 min.

**Mitrovicë  
10.02.2026**

**Procesmbajtës:**

**Afërdita MAXHUNI**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Safet KAMBERI**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0008621-1/26 dt. 17.02.2026**  
**Mitrovicë**

**PROCESVERBAL**  
**Nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës**  
**(Mbledhja e 5-të)**

**Koha:** 17.02.2025 ora 10:00

**Vendi:** Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

**Të pranishëm:** Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi,

Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Igballe Islami, Ferdi Kadriu, Artan Berisha, Egzon Hamza, Gëzim Stavileci, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Liridona Muharremi, Nazmije Sejdiu, Lavdim Zeneli, Armend Begu, Jeton Zeneli, Erseka Barani, Rinesa Preteni, Sazan Ramaxhiku, Bajram Istrefi, Visar Syla, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Rozana Peci, Oltion Ahmeti, Xhylyeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda  
Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Nënkryetari Enis Osmani

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të Policisë së Kosovës

Mediat

**Mungoi:** Kushtrim Zeneli

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi i cili theksoi se në zbatim të nenit 43, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 8, paragrafët: 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 9, paragrafët: 1 dhe 3, nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, dhe nenit 55, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në konsultim me Kryetarin e Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen solemne:

**Kushtuar "17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës"**

Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes mbajti një fjalë rasti:

Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi: Të nderuar anëtarë të Kuvendit. Të respektuar përfaqësues të institucioneve. Të dashur qytetarë. Sot shënojmë një ditë që nuk

është vetëm një datë në kalendarin tonë shtetëror, por një kujtesë e gjallë e rrugës së gjatë dhe të mundimshme drejt lirisë. Tetëmbëdhjetë vite më parë, Kosova u bë shtet i pavarur, duke kurorëzuar sakrificën dhe përkushtimin e brezave që besuan se liria është një e drejtë që nuk negociohet. Kjo ditë na bashkon të gjithëve. Liria e Kosovës është rezultat i një përpjekjeje të përbashkët: të atyre që rezistuan, të atyre që vepruan me mençuri politike dhe të atyre që sakrifikuan jetën që ne sot të jetojmë të lirë. Mitrovica ka dhënë shumë për lirinë e Kosovës, si gjatë luftës, ashtu edhe pas saj. Ngjarjet e marsit 2004 dëshmuar sfidat që ka përballuar, por edhe qëndrueshmërinë e saj. Sot, Mitrovica mbetet simbol i qëndresës dhe i besimit në të ardhmen e Kosovës. Binomi i dy figurave - Presidenti historik Ibrahim Rugova dhe kryekomandanti Adem Jashari - simbolizon shtetin e Kosovës. Rugova përfaqëson vizionin politik dhe përpjekjen e palodhshme për ndërtimin e shtetit dhe për ta bërë Kosovën të dëgjuar e të respektuar ndërkombëtarisht. Adem Jashari përfaqëson Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificën e të gjithë dëshmorëve që dhanë jetën për liri, duke mishëruar qëndresën, guximin dhe vendosmërinë e popullit tonë. Këto dy dimensione - sakrifica dhe vizioni - janë themeli mbi të cilin qëndron liria dhe shtetësia jonë. Të nderuar qytetarë. Sot kujtojmë me respekt të gjithë dëshmorët, invalidët dhe çdo qytetar që kontribuoi në këtë rrugë. Sakrifica e tyre është themeli mbi të cilin qëndron Republika jonë. Obligimi ynë është ta ruajmë këtë trashëgimi duke ndërtuar institucione të drejta dhe një shtet që u shërben qytetarëve me dinjitet. Në këtë përvjetor shprehim solidaritetin dhe mbështetjen tonë morale për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po përballen me proceset gjyqësore në Hagë. Lufta e UÇK-së ishte një luftë çlirimtare, e drejtë për liri dhe dinjitet, dhe besojmë se drejtësia e paanshme do ta konfirmojë këtë të vërtetë. E ardhmja e Kosovës varet nga aftësia jonë për të qëndruar të bashkuar. Më shumë se kurrë kemi nevojë për unitet, përgjegjësi dhe besim në njëri-tjetrin. Vetëm kështu mund të ndërtojmë një shtet më të drejtë, më të zhvilluar dhe më të sigurt për brezat që vijnë. Le të jetë ky përvjetor një moment krenarie, por edhe një zotim i ri që ta ruajmë frymën e bashkimit dhe ta çojmë përpara Republikën tonë me përkushtim dhe vizion, duke mos harruar kurrë çmimin e lirisë. Urime 18-vjetori i Pavarësisë së Republikës së Kosovës! Lavdi të gjithë atyre që sakrifikuan për lirinë! Zoti e bekoftë Kosovën dhe qytetarët e saj! Faleminderit!

Shkëlqim Ibrahim: Të dashur qytetarë. Sot festojmë me krenari 17 shkurtin, Ditën e Republikës sonë, një nga momentet më të ndritura në historinë e kombit tonë dhe të shtetit tonë modern. Republika e Kosovës është simbol i pavarësisë, sovranitetit kombëtar dhe vullnetit të palëkundur të popullit tonë. Në këtë ditë të madhe kujtojmë me nderim të thellë sakrificën e Familjes Jashari që u bë themel i lirisë sonë. Është detyra jonë të mbrojmë vlerat e Republikës së Kosovës, të forcojmë unitetin tonë dhe të punojmë për një të ardhme më të drejtë, më të sigurt dhe më të begatë. Të çlirohemi kërkon guxim. Ka nënkuptim të përballësh me pasiguri, por me vendosmëri. Ka nënkuptim të besosh në veten tënde edhe kur të tjerët vënë në dyshim zgjedhjet e tua. Çdo arritje e madhe në historinë njerëzore ka nisur me dikë që vendosi të çlirohej nga ajo që e mbante prapa. E tillë ishte edhe përpjekja jonë për liri dhe po ashtu një njeri që guxoi të niste çlirimin. Çlirimi kulmoi me pavarësi. Kjo arritje i përket çdo qytetari që ëndërroi lirinë. I përket mësuesve që edukuan në vështirësi breza, profesorëve që mbajtën gjallë gjuhën dhe kulturën tonë, mjekëve dhe mantelbardhëve që sakrifikuan shumë, bujqve që ushqyen luftëtarët e UÇK-së, prindërve tanë që rritën fëmijët e tyre me besimin në një të nesërme më të mirë dhe kështu secili prej jush ka luajtur një rol në sjelljen tonë në këtë moment historik. Po ashtu, nuk mund te

flasim për rrugëtimin drejt pavarësisë pa përmendur figurat kryesore politike dhe udhëheqësit që bartën përgjegjësi në momentet vendimtare të shtetformimit dhe që ishin në piedestalet më të larta të përpjekjes për liri, drejtorin politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe njëherazi Shpallësi i Pavarësisë së Republikës së Kosovës Presidenti z. Hashim Thaçi dhe shokët e tij kryetari Kadri Veseli, z. Jakup Krasniqi dhe z. Rexhep Selimi të cilët ishin bartës të proceseve historike që quan në shpalljen e pavarësisë dhe në konsolidimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, ndërsa sot po përballen me padrejtësi politike në Hagë. Një gjyq politik, i stërmbytur me dëshmi nga agresori serb, ka sulmuar dhe tentuar të njollosë luftën e drejtë dhe përpjekjet për liri. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi janë sinonim i guximit, që refuzuan të përulën para shtypjes, siç bëri Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe populli ynë. Ata zgjodhën të ngrihen dikur për të qëndruar sot, të flasin dikur për të dëshmuar sot, të luftojnë për atë që besonin dhe që ishte e drejtë, për të vendosur sot edhe njëherë për pastërtinë dhe të drejtën e luftës. Shumëkush tha se kjo ditë nuk do të vinte kurrë. Thanë se ishim shumë të pakët, të përçarë për të qeverisur veten. Por ata nuk e kuptuan fuqinë e unitetit, forcën e qëllimit të përbashkët dhe thellësinë e vendosmërisë sonë. Ne ua dëshmuam të kundërtën me këmbëngulje, me bashkim dhe me besim të palëkundur në kauzën tonë. Në këtë 17 Shkurt, le të jemi të bashkuar rreth vlerave të lirisë, demokracisë dhe drejtësisë. Le ta konfirmojmë përkushtimin tonë ndaj Republikës sonë, ndaj sakrificës së atyre që dhanë gjithçka dhe ndaj përgjegjësisë që kemi për brezat që do të vijnë. Urime 17 Shkurti, Dita e Pavarësisë! Zoti e bekoftë Kosovën!

Sazan Ramaxhiku: Jemi mbledhur në këtë seancë për ta kujtuar dhe nderuar një nga datat më të mëdha të historisë sonë, një nga ditët më të merituarat për liri e pavarësi. Prandaj, me respekt të thellë përkulemi para dëshmorëve, të cilët në momentet më të vështira morën mbi supë barrën e lirisë në të gjitha luftërat që kaloi populli shqiptar, luftëra të cilat ishin për dinjtet dhe për të drejtën tonë për shtet. Ideja për vetëvendosje daton që nga përpjekjet e para kombëtare për liri, nga kryengritjet dhe organizimet politike, nga programet e rilindësve tanë dhe nga çdo formë rezistence kundër pushtimit dhe mohimit të të drejtave kombëtare. Në çdo etapë të rrugëtimit tonë – nga rezistenca paqësore, te lufta çlirimtare dhe deri te shtetndërtimi – kjo ide ka qenë boshti i aspiratës sonë për liri dhe sovranitet. Andaj, në ditë të veçanta, në ditë të mëdha, është e pamundur të mos kthejmë kokën mbrapa. 17 Shkurti është kurorëzimi – por rruga drejt tij ka qenë e gjatë, e mundimshme dhe e dhimbshme. E kujtojmë qëndresën kundër perandorive dhe pushtuesve. E kujtojmë luftën kundër xhonturqve dhe çlirimin e Shkupit. E kujtojmë Hasan Prishtinën, që zgjodhi kryengritjen para kolltukëve. E kujtojmë Isa Boletini, i cili që nga moshën 16-vjeçare nuk e ndali pushkën dhe dha gjithçka për liri e Shqipëri. E kujtojmë pushtimin e parë (1912), të dytin (1918) dhe të tretin (1945). Lumenjtë e gjakut nga gjenocidet – por shpirtin shqiptar që kurrë nuk u nënshtroa. Kujtojmë ilegalitetin, rezistencën paqësore, demonstratat dhe aksionet e para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kujtojmë sakrificën e komandantit Adem Jashari me tërë familjen – një rast unik në historinë botërore. Gjakun e dëshmorëve. Luftën heroike të trimave tanë, sidomos nga Zona Operative e Shalës së Bajgorës. Sot, mbi të gjitha, ne besojmë se e vërteta do të triumfojë. Besojmë se drejtësia nuk mund ta zhbëjë karakterin çlirimtar të luftës sonë dhe se në fund do të konfirmohet ajo që populli ynë e di: se sakrificat për liri ishte e drejtë dhe e pastër. Në këtë frymë, edhe Lëvizja Vetëvendosje ka dhënë kontributin e saj politik e institucional, duke ngritur zërin për sovranitet, për mbrojtje të interesit publik dhe kundër kompromiseve të dëmshme. Sot kemi ushtrinë tonë,

shtetin tonë, Kosova e lirë. Por bashkë me lirinë kemi edhe përgjegjësi: përgjegjësi për ta forcuar ekonominë, për ta ngritur drejtësinë dhe për ta mbrojtur sovranitetin cep më cep. Sepse liria nuk është vetëm trashëgimi – është amanet. Amanet që ta ruajmë me punë, me ndershmëri dhe me unitet. Amanet që sot po e shohim të materializuar edhe në veriun e vendit, ku simbolet e Republikës respektohen dhe rendi kushtetues shtrihet në çdo cep të territorit. Amanet që na e rikujtoi me gjakun e tij edhe rënia heroike e rreshterit Afrim Bunjaku, i cili në sulmin terrorist në Banjskë dëshmoi se sovraniteti nuk është fjalë – por sakrificë. Amanet që fëmijët tanë ta jetojnë Kosovën më të fortë, më të drejtë dhe më të zhvilluar se ne sot. Le të jemi brezi që sakrificën e shndërron në zhvillim, gjakun në shtetndërtim dhe dhimbjen në forcë. Le të jemi brezi që e mban lart flamurin e përgjegjësisë, ashtu siç e mbajtën ata flamurin e lirisë. Republika jonë do të jetojë përjetësisht – sepse është ndërtuar mbi sakrificë dhe mbi besim në liri. Gëzuar Mitrovicë! Gëzuar Kosovë!

Visar Syla: I nderuar Kryetar. I nderuar Nënkryetar. I nderuar Kryesues. Të nderuar asamblastë/e. Të nderuar përfaqësues të institucioneve. Të nderuar përfaqësues të mediave. Të nderuar bashkëqytetarë. Sot është dita kur u vulos sakrifica e brezave dhe u jetësua ëndrra shekullore për liri. Më 17 Shkurt 2008, në Kosovë, u shpall pavarësia, si amanet i të rënëve dhe si përgjegjësi për ne që jetojmë sot. Kjo ditë lidhet fort me 28 Nëntorin e Shqipërisë, kur në vitin 1912 u ngrit flamuri i lirisë në Vlorë nga Ismail Qemali. Aty nisi udha e shtetësisë sonë; këtu, në Kosovë, ajo u përmbush me gjakun dhe qëndresën e popullit tonë. Ne nuk e fituam lirinë dhuratë. Ajo erdhi pas dekadash përpjekjeje, pas sakrificës së mijëra dëshmorëve dhe pas luftës çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Emrat e heronjve tanë, si Adem Jashari, janë gurë themeli të këtij shteti, simbol i guximit, i flijimit dhe i krenarisë kombëtare. Sot, kur festojmë pavarësinë, ne nuk festojmë vetëm një akt politik. Ne festojmë identitetin, gjuhën, flamurin, kulturën dhe të drejtën për të vendosur vetë për fatin tonë. Por liria nuk është vetëm e drejtë, është edhe detyrë. Detyrë për ta ndërtuar Kosovën me drejtësi, me zhvillim, me unitet dhe me besim në të ardhmen. Le ta mbajmë gjallë frymën e 28 Nëntorit dhe të 17 Shkurtit në çdo veprim tonin. Le të jemi të bashkuar përtej dallimeve, sepse vetëm të bashkuar jemi të pathyeshëm. Rroftë Kosova e pavarur! Rroftë kombi shqiptar!

Gjergj Beka: I nderuar Kryesues. I nderuar Kryetar. Te nderuar Kolegë. Te nderuar mysafirë. Të nderuar të pranishëm. Të dashur qytetarë. Sot, në 18-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, qëndrojmë krenarë përpara historisë sonë. Tetëmbëdhjetë vite më parë, më 17 shkurt 2008, në Prishtinë u vulos ëndrra shekullore e popullit tonë për liri dhe shtetësi. Kjo ditë nuk erdhi lehtë. Ajo është fryt i sakrificës së brezave të tërë. Me respekt të thellë kujtojmë Presidentin historik Ibrahim Rugova, i cili me urtësi dhe vizion e mbajti gjallë kauzën e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Me nderim të përjetshëm kujtojmë familjen heroike Adem Jashari dhe gjithë familjen Jashari, simbol të qëndresës dhe sakrificës sonë kombëtare. Kujtojmë të gjithë dëshmorët dhe të rënët për liri, të cilët me gjakun e tyre shkruan historinë e shtetit tonë. Një kapitull i veçantë i kësaj historie i takon Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe drejtuesve të saj. Sot, në këtë përvjetor, nuk mund të mos përmendim krerët e UÇK-së që po përballen me procese gjyqësore në Hagë: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Pavarësisht zhvillimeve dhe proceseve që po zhvillohen, historia e luftës për liri dhe roli i tyre në atë periudhë mbeten pjesë e pandashme e rrugëtimit tonë drejt shtetit. Lufta e UÇK-së ishte thirrje për liri, për dinjitet dhe për të drejtën për të jetuar të barabartë në tokën tonë. Në mënyrë të veçantë, sot

kujtojmë rolin e Hashim Thaçit si një ndër figurat kyçe të procesit politik që çoi në shpalljen e Pavarësisë. Si Kryeministër i Kosovës në atë kohë, ai ishte zëri që lexoi Deklaratën e Pavarësisë, duke e bërë realitet ëndrrën e shumë brezave. Ajo ditë shënoi jo vetëm lindjen e një shteti të ri, por edhe kurorëzimin e një sakrifice të gjatë kombëtare. 18 vite shtet janë 18 vite përgjegjësi. Pavarësia nuk është vetëm një datë në kalendar; ajo është përkushtim i përditshëm për ta forcuar shtetin tonë, për ta zhvilluar ekonominë, për ta fuqizuar drejtësinë dhe për ta ruajtur unitetin tonë kombëtar. Sot, më shumë se kurrë, duhet të qëndrojmë të bashkuar. Të nderojmë të kaluarën tonë, të respektojmë sakrificën dhe të ndërtojmë me mençuri të ardhmen. Le ta ruajmë Kosovën si amanet të dëshmorëve dhe si shpresë për fëmijët tanë. Urime 18-vjetori i Pavarësisë, Kosovë! Qofsh gjithmonë e lirë, e pavarur dhe krenare!

Flamur Vojvoda: I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal. I nderuar Kryetar i Komunës. Të nderuar asamblistë, përfaqësues të institucioneve, familje të dëshmorëve, veteranë të luftës dhe qytetarë të respektuar. Sot jemi mbledhur për të shënuar me krenari dhe dinjitet përvjetorin e Pavarësisë së Kosova, një datë që përfaqëson realizimin e një ëndrrë shekullore të popullit tonë për liri, shtetësi dhe dinjitet. Pavarësia e Kosovës, e shpallur më 17 shkurt 2008, është fryt i sakrificës së brezave të tërë, i përpjekjeve të pandalshme politike e diplomatike, por mbi të gjitha i gjakut të derdhur për liri. Në themelet e shtetit tonë qëndron lufta e drejtë dhe çlirimtare e Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila u bë zëri dhe arma e një populli që kërkonte të jetonte i lirë në tokën e vet. Sot përkulemi me respekt të thellë para Familjes Heroike të Komandantit legjendar, Adem Jashari, dëshmorëve të kombit, invalidëve dhe veteranëve të luftës. Sakrifika e tyre është themeli mbi të cilin qëndron Republika jonë. Lufta e UÇK-së ishte një luftë për mbijetesë, për dinjitet njerëzor dhe për të drejtën për të qenë të barabartë mes kombeve të lira të botës. Sot jemi dëshmitarë të një procesi gjyqësor që po zhvillohet në Hagë kundër disa prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne besojmë fuqishëm në pafajësinë e tyre dhe në drejtësinë e luftës së bijve dhe bijave të UÇK-së - një luftë për liri, dinjitet dhe të drejta themelore. Thirrja për drejtësi sot është zëri i një populli që qëndron me bindje në anën e së vërtetës, që beson në vlerat evropiane, në sundimin e ligjit dhe në drejtësinë e paanshme. Është një thirrje për dinjitet kombëtar, për respekt ndaj sakrificës dhe për triumfin e së drejtës mbi çdo paragjykim. Si përfaqësues të qytetarëve në këtë asamble, kemi përgjegjësi të veçantë ta ruajmë frymën e unitetit dhe ta forcojmë besimin e qytetarëve në institucionet tona. Pavarësia e Kosovës është projekt i përbashkët mbi dallimet politike, mbi interesat personale dhe mbi çdo ndarje. Në këtë përvjetor, le ta kujtojmë të kaluarën me krenari, ta jetojmë të tashmen me përgjegjësi dhe ta ndërtojmë të ardhmen me besim, duke punuar çdo ditë për një Kosovë më të drejtë, më të zhvilluar dhe më të fortë. Lavdi të rënëve për liri! Nderim i përjetshëm për sakrificën e tyre! Urime përvjetori i Pavarësisë së Kosovës!

Kryetari Faton Peci: Të nderuar. Jemi mbledhur sot këtu, në këtë seancë solemne, si përfaqësues të qytetarëve, për të shënuar Ditën e Pavarësisë. Kjo datë me rëndësi historike është sublimim i sakrificës gjithpopullore ndër shekuj. Shqiptarët në këto treva janë popull autokton që gjithë jetën e tyre janë angazhuar dhe kanë luftuar për lirinë e popullit të vet. Asnjëherë aspirata jonë nuk ka qenë pushtuese; luftërat ndër shekuj kanë qenë vetëm për të jetuar të lirë dhe me dinjitet. Betejat e pushtuesve kanë qenë interesa për pasuri mbitokësore dhe nëntokësore, ambicie për gllabërim të territoreve, të cilat ndër shekuj janë përballur me guximin dhe trimërinë e shumë grave dhe burrave atdhetarë dhe

patriotë, që kanë dhënë gjithçka nga jeta e tyre që ne sot të jetojmë të lirë. Mitrovica, në aspektin gjeopolitik e gjeostrategjik, ka qenë, është dhe do të mbetet qyteti me peshën më të madhe politike. Këtu vendoset çdoherë për të ardhmen e shqiptarëve, përtej rëndësisë edhe të Republikës. Mjafton të kthehemi në retrospektivë dhe të kujtojmë eksodin e shpërnguljes së 700 fshatrave shqiptarë dhe ndryshimin e realitetit faktik, ku prezenca më domethënëse e shqiptarëve mbetet në Mitrovicë dhe një pjesë me dominancë në veri. Të kujtojmë se për lirinë e këtij trualli, Mitrovica ishte larë e tëra me gjak në vitin 1903, kur me qindra burra, shumica e të cilëve ishin nga ky qytet. Sepse Mitrovica ishte e rëndësisë strategjike, kur interesat ndaheshin edhe në mes të Perandorisë Osmane dhe Ruisë cariste. Beteja për pavarësinë e shqiptarëve kishte filluar nga kryengritjet në Kosovë, me protagonistin kryesor në aspektin ushtarak, heroin Isa Boletini, dhe vazhduan deri në vitin 2023, me heroin e fundit të Kosovës, heroin Afrim Bunjaku. Kosova e vuajtur, pas dy luftërave botërore dhe e mbetur pa vullnetin e qytetarëve që kërkonin vetëvendosje, mbeti jashtë shtetit shqiptar, brenda krijesës së quajtur Jugosllavi, ku trajtimi ynë ishte në një kategori tjetër. Përkundër avancimeve që kishin ndodhur në vitet '70, në aspektin arsimor, por edhe ekonomik, nefsi i shqiptarit patriot kërkonte liri të plotë. Ato filluan përmes demonstratave për afër dy dekada. E kur bota po ndryshonte, muri i Berlinit ra, kjo pjesë e Evropës kishte në krye të Jugosllavisë kasapin e Ballkanit, që synonte vrasje, spastrim etnik, e realizoi gjenocid në Bosnje e Kosovë. Neve, si popull, Zoti i madh na bekoji me një Ibrahim Rugovë. Ai arriti që në historinë e shqiptarëve të bëjë bashkë një popull të tërë. Ishte një lëvizje gjithpopullore që afirmonte liritë njerëzore, që sensibilizoi të drejtat e një populli për vetëvendosje në çdo kancelari të botës demokratike e perëndimore. Sa më shumë që kishte rezistencë, aq më shumë rritej presioni e terrori mbi një popull civil të pambrojtur. Rrjedhat politike çuan në drejtim që çdo ditë e më shumë ishte pothuajse e pamundur të evitohej rezistenca e armatosur. Si e tillë, ajo kulmoi me një familje e cila u flijua pothuajse e tëra për Kosovën; ajo kishte protagonist Adem Jasharin dhe rezistencën e flijimit e paparë ndonjëherë në histori, jo vetëm të kombit shqiptar. Kjo rënie e ky frymëzim bëri që të rinj e të reja dhe një popull i tërë të rreshtohen në organizimin e rezistencës dhe luftës çlirimtare. Sot, nën dritën e kësaj dite historike, Kosova feston me krenari si shtet i lirë dhe sovran, i ndërtuar mbi sakrificën dhe përkushtimin e brezave. Sovraniteti ynë është simbol i qëndresës, i gjakut të dëshmorëve dhe i ëndrrës shekullore për liri.

Kryesuesi mbylli mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës.

**Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:55 min.**

**Mitrovicë**

**Procesmbajtës:**

**Kryesuesi i mbledhjes**

**Afërdita MAXHUNI**

**Safet KAMBERI**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0011324-1/26 dt. 05.03.2026**  
**Mitrovicë**

**PROCESVERBAL**  
**Nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës**  
**(Mbledhja e 6-të)**

**Koha:** 05.03.2025 ora 10:00

**Vendi:** Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

**Të pranishëm:** Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi,

Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahim, Igballe Islami, Ferdi Kadriu, Artan Berisha, Egzon Hamza, Gëzim Stavileci, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Liridona Muharremi, Nazmije Sejdiu, Lavdim Zeneli, Armend Begu, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Rinesa Preteni, Sazan Ramaxhiku, Bajram Istrefi, Visar Syla, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Rozana Peci, Oltion Ahmeti, Xhyljeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Nënkryetari Enis Osmani

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të FSK-së

Përfaqësues të Policisë së Kosovës

Përfaqësues të klerit fetar

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Drejtorë të shkollave

Mediat

**Mungoi:** Fisnik Suma dhe Majlinda Kurti

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi i cili theksoi se në zbatim të nenit 43, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 8, paragrafët: 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 9, paragrafët: 1 dhe 3, nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, dhe nenit 55, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në konsultim me Kryetarin e Komunës, në harmoni me Agjendën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për aktivitetet e manifestimit "Epopeja e UÇK-së" 2026, në

vazhdën e manifestimeve dhe në shenjë nderimi dhe kujtimi për 28-vjetorin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për sot ka thirrur mbledhjen solemne:

**Kushtuar "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rënies heroike të Komandantit legjendar Adem Jashari dhe të gjithë të rënëve për liri"**

Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes mbajti një fjalë rasti:

Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi: I nderuar Kryetar i Komunës. Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal. Të respektuara familje të dëshmorëve. Veteranë e invalidë të luftës. Të nderuar qytetarë të Mitrovicës. Sot jemi mbledhur në këtë seancë solemne për të nderuar Epopenë e UÇK-së – një moment themelor i historisë sonë moderne dhe një pikë kthese që përcaktoi fatin e Kosovës. Rënia historike e komandantit legjendar Adem Jashari, së bashku me familjen e tij dhe me të gjithë të rënët për liri, shënoi ngritjen morale dhe kombëtare të një populli që vendosi të mos jetojë më në nënshtrim. Në Prekaz u dëshmuar se liria ka çmim, por edhe se dinjiteti nuk dorëzohet. Aty u vulos me sakrificë rruga e pakthyeshme drejt çlirimit. Epopeja e UÇK-së është më shumë se kujtesë historike. Ajo është standard i përgjegjësisë sonë institucionale. Është matësi moral me të cilin duhet ta peshojmë çdo vendim dhe çdo veprim në shërbim të qytetarëve dhe të shtetit. Mitrovica ka një vend të veçantë në historinë e luftës çlirimtare. Komuna jonë ishte pjesë aktive e organizimit dhe e rezistencës, duke u rreshtuar qartësisht në anën e lirisë. Në veçanti, Zona Operative e Shalës përfaqëson një nga strukturat më të rëndësishme të UÇK-së në rajonin tonë. Ajo u bë vatër e mobilizimit, e organizimit ushtarak dhe e qëndresës së pathyeshme. Nga kjo zonë dolën luftëtarë të përkushtuar, drejtues e ushtarë të devotshëm, ndërsa shumë prej tyre ranë në altarin e lirisë, duke u bërë dëshmorë të kombit. Sakrifika e tyre është pjesë e themeleve mbi të cilat qëndron sot Republika e Kosovës. Sot, detyrimi ynë nuk përfundon me përkujtim. Ai vazhdon me përgjegjësi. Nderimi më i madh për dëshmorët është ndërtimi i një shteti funksional, me institucione të forta, me ligj e barazi për të gjithë. Është përkushtimi ynë që liria për të cilën u sakrifikua të përkthehet në zhvillim, mirëqenie dhe perspektivë për brezat që vijnë. Kjo seancë solemne është akt nderimi, por edhe akt zotimi. Zotim se do ta ruajmë me dinjitet historinë tonë. Zotim se do të punojmë me ndershmeri dhe përkushtim për Mitrovicën dhe për Republikën e Kosovës. Lavdi e përjetshme komandantit legjendar Adem Jashari. Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit. Nderim i përhershëm luftëtarëve të lirisë. Rroftë Republika e Kosovës!

Shkëlqim Ibrahim: Muaji mars është shënimi i identitetit tonë kombëtar e shtetëror. Ky muaj përkon fuqishëm në ndjenjat tona, sa me dhimbje, aq me krenari. Përvjetori i sulmit të forcave të armatosura serbe kundër familjes Jashari, të cilët rezistuan deri në flijim, në krye me komandantin Adem Jashari, është përvjetori i zgjimit tonë kombëtar, që nisi nga organizimet e patriotëve të shquar, studentëve të rebeluar, akademikëve të panështruar, nënave dhe motrave tona që sakrifikuan, kundër agresorit e pushtuesit të kamotshëm serb. Është muaji i shndërrimit të sakrificave dhe dhimbjes në krenari, është vlera që japin vetëm heronjtë, siç janë Jasharët që ranë atë natë. Vlerën e mirëfilltë të çdo personaliteti të shquar të një kombi e tregon më së miri qëndrimi i brezave të mëvonshëm ndaj veprës dhe trashëgimisë që kanë lënë pas. Sa më shumë krijohet distancë historike aq më shumë rritet madhështia e figurës së Adem e Hamzë Jasharit, si luftëtarë, si vizionarë dhe si lajmëtarë se sakrifika e tyre do të mobilizojë kombin, do të

mobilizojë shqiptarët në Evropë, Amerikë dhe në gjithë globin. Rrugëtimi dhe sakrifica e familjes Jashari, pos që gjeti jehonë dhe bëri ndikim shumë të gjerë në hapësirat shqiptare si dhe në diasporë, përmban fljimin më të veçantë në historinë tonë dhe rrallë e gjendur në historitë e kombeve të tjera. Flijimi i familjes Jashari, pos që ishte unik në historinë e kombit tonë duke mobilizuar dhe rritur kohezionin e shqiptarëve gjithandej në botë, sot dhe në të ardhmen dhe përgjithmonë do të mbetet frymëzim, pikë referimi dhe inspirimi për brezat që do të vijnë. Kujtesa jonë shoqërore nuk është e plotësuar pa amanetin e tyre. E amaneti i tyre ishte liria. Liria duhet mbrojtur, ditë e natë, minutë e çast, sepse, është e ndërtuar mbi sakrificë, munde e jetëra. Ajo është ndërtuar mbi gjakun e dëshmorëve, martirëve dhe atyre që humbën gjymtyrët për atë që ne sot të jemi, të lirë. Ndihej i privilegjuar, e po aq ballë lartë, që dekada pas, historia më vendosi para një momenti, që institucionalisht të flas për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe familjen Jashari. Epopeja është vazhdimësi e përpjekës sonë, jo vetëm kujtesë e nderim. Është detyra jonë e veprimit. Rroftë amaneti i heronjve tanë! Rroftë historia e familjes Jashari dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Zoti na ndihmoftë në rrugën për përmbushjen e idealeve tona, për një vend me të ardhme të ndritshme, si ëndrra e dëshmorëve tanë. Lavdi dhe përjetësi për komandantin Adem Jashari dhe të gjithë dëshmorët e kombit!

Kushtrim Zeneli: Përshëndetje për të gjithë. Në themelet e qëndresës së familjes Jashari qëndron figura e burrit dhe mësuesit të urtë Shaban Jashari. Nga kjo familje dolën luftëtarët Adem dhe Hamëz Jashari, të cilët me sakrificën e tyre heroike e shndërruan Prekazin në simbol të qëndresës dhe krenarisë sonë kombëtare. I nderuar Kryetar i Komunës Faton Peci, familje të dëshmorëve, invalidë të luftës, përfaqësues të Bashkësisë Islame, kryesues i Kuvendit Komunal të Mitrovicës, të nderuar asamblistë, kolegë të ekzekutivit, përfaqësues të institucioneve dhe qytetarë të nderuar. Sot jemi mbledhur në Kuvendin Komunal të Mitrovicës për të përkujtuar me respektin më të madh një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare – Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Historia e luftës sonë për liri është një dëshmi e qartë se asnjë fuqi, sado e madhe dhe e pamëshirshme të jetë, nuk mund ta mposhtë vullnetin e një populli të vendosur për të jetuar i lirë në tokën e vet. Historia e kombit tonë është histori sakrifice dhe qëndrese, por pak ngjarje kanë vulosur fatin tonë si popull sa Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Datat 5, 6 dhe 7 mars janë të gdhendura përgjithmonë në historinë e Republikës sonë. Ato përfaqësojnë gurthemelin e pavarësisë sonë, momentin sublim të rezistencës, guximit, patriotizmit dhe atdhedashurisë. Epopeja është krenaria jonë kombëtare dhe udhërrëfyesi ynë për të ardhmen. Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës simbolizon qëndresën heroike të popullit shqiptar përballë shtypjes, dhunës dhe përpjekjeve për spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës. Qëndresa e familjes së Adem Jasharit frymëzoi kombin dhe e shndërroi luftën për liri në një rrugë pa kthim drejt pavarësisë. Komandanti legjendar Adem Jashari dhe familja e tij dhanë jetën në mbrojtje të lirisë, duke e kthyer sakrificën e tyre në simbol të bashkimit dhe vendosmërisë kombëtare. Rënia heroike e tyre ishte momenti kur bota kuptoi se shqiptarët e Kosovës nuk do të dorëzoheshin kurrë. Pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nuk do të kishim arritur një Kosovë të lirë dhe të pavarur. UÇK-ja nuk ishte një ushtri e zakonshme; ajo buroi nga populli, u ushqye me idealin kombëtar dhe ishte vazhdimësi e rezistencës shqiptare ndër shekuj - nga epoka e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, te Lidhja e Prizrenit, nga Azem Galica e Shaban Polluzha, nga Isa Boletini, tek Ukshin Kovaqica e Kadri Bistrica simbol të qëndresës shqiptare, e deri te lëvizjet studentore të viteve '80 dhe '90 që treguan përkushtimin e brezave të rinj

për të ruajtur aspiratën për liri dhe për të mbajtur gjallë shpirtin kombëtar. Nga kjo vazhdimësi lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila trashëgoi amanetin e të parëve dhe e çoi betejën për liri deri në fitore, deri tek rënia e heroit tone Afrim Bunjaku, duke mbrojtur sovranitetin, rendin dhe paqen e Kosovës dëshmoi se sakrificat për lirinë nuk ka fund dhe vazhdon çdo ditë për të mbrojtur atë që është fituar me gjak e me nder. Pas 7 marsit 1998, UÇK-ja u rrit dhe u forcua. Luftëtarë të rinj të lirisë, të frymëzuar nga sakrificat e familjes Jashari, iu bashkuan luftës për çlirimin e çdo pjese të Kosovës. Jehona e pushkëve të UÇK-së u bë zëri i lirisë që e dëgjoji bota. Dhe këtë të vërtetë e shpreh fuqishëm edhe fjala e heroit Hamëz Jashari: “Kush është i marrë të qëndrojë në mal kur këtu gjithandej është tokë etnikisht e pastër shqiptare? Këtu nuk mban mend askush që ka pasur serbë ndonjëherë. Prej Ilirëve, pellazgëve; qysh kur Dielli e ngroh këtë tokë, ne jemi këtu. Serbët kanë ardhur në 1928! Nuk ka pasur kurrë më parë. Ata rrenë, ata e bëjnë historinë si u duhet atyre.” Kjo thënie është dëshmi e besimit të pathyeshëm në identitetin dhe të drejtën tonë për të jetuar të lirë në tokën tonë, një mesazh që na obligon të qëndrojmë të bashkuar, vigjilentë dhe krenarë për shtetin tonë. Mesazhi i Epopesë është i qartë: liria fitohet me sakrificë, por ruhet çdo ditë me përgjegjësi, guxim dhe përkushtim ndaj shtetit tonë. Nderimi më i madh për sakrificën e tyre është puna jonë e përditshme për Republikën dhe mbrojtjen e sovranitetit të saj. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit! Lavdi familjes Jashari! Lavdi të gjithë atyre që ranë për lirinë e Kosovës! Rroftë Republika e Kosovës!

Elfate Ademi Bahtiri: I nderuar kryetar, i nderuari kryesues dhe të gjithë të pranishëm në këtë sallë. Sot jemi këtu për të kujtuar një epokë që ndryshoi rrjedhat e historisë sonë kombëtare. Drenica, djepi i trimërisë e i varrit i barbarisë. Më 5 Mars të vitit 1998, një krismë pushke jehoi në atë mënyrë që ndryshoi rrjedhat e historisë. Ajo krismë zgjoi nga gjumi Europën dhe mbarë botën. 2 mijë vjet mbijetesë e qëndresë për liri morën kuptim të ri në tokën e Drenicës. Drenica e Ahmet Delisë e Shaban Polluzhës, e Mehmet Gradicës, e Tahir Mehës, e Hasan Prishtinës e Azem Galicës dhe shumë trimave të tjerë dëshmon edhe njëherë se kjo tokë lind heronj. Dhe në fund mbi tokën e saj ra edhe Adem Jashari bashkë me familjen dhe luftëtarët e tij duke u bërë simbol i sakrificës më të lartë për liri. Me ta nisi një epokë e re, epoka e madhe e lirisë. Lavdia e Adem Jasharit nuk ka kufij, ajo përjetohet dhe nderohet kudo ku buka quhet bukë dhe uji quhet ujë, kudo ku frymon drejtësia dhe dinjiteti. Vitet kalojnë, por drita e lirisë, drita e atyre që ranë për të nuk do të zbehet kurrë. Le të përulemi me respekt para veprës dhe sakrificës së tyre. Le ta kujtojmë gjithmonë se liria që gëzojmë sot është amaneti i tyre. Është detyra jonë ta ruajmë, ta forcojmë dhe ta përcjellim brez pas brezi, me dinjitet, unitet dhe dashuri për atdheun. Lavdi të përjetshme Heronjve të Kombit.

Xhyljeta Imeri: Sot jemi mbledhur për të nderuar Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rënien heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe të gjithë të rënëve për liri. Më 5, 6 dhe 7 mars 1998, rezistenca e familjes Jashari, e mbyllur në kullën e tyre duke mbrojtur pragun e shtëpisë dhe Kosovën nga forcat policore serbe, unifikoi dhe i dha forcë e shpresë popullit për të vazhduar luftën për çlirim. Derisa vijonte sulmi i forcave serbe në Prekaz, Presidenti historik i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, më 6 mars 1998, bënte thirrje që Bashkësia Ndërkombëtare të ndalte agresionin serb dhe Kosova të merrej urgjentisht nën mbrojtjen ndërkombëtare, duke lënë të nënkuptohej edhe mbrojtja ushtarake e NATO-s. Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk është vetëm një ngjarje historike, por është themel i lirisë sonë. Sakrificat e familjes Jashari dhe e mijëra dëshmorëve na obligon çdo ditë të punojmë me ndershmeri për shtetin tonë. Sot dua të përmend me respekt edhe

figurën e Shaban Jasharit, i cili, përveçse ishte prind i një familjeje heroike, ishte edhe mësues. Ai edukoi breza me dashuri për atdheun dhe me dije, sepse liria nuk fitohet vetëm me pushkë, por edhe me dije. Nga kjo frymë edukimi dhe atdhedashurie u rritën bijtë e bacës Shaban dhe nënës Zahide, që më vonë do të bëheshin simbol i rezistencës kombëtare. Si mësuese, e ndiej këtë përgjegjësi çdo ditë. Edukimi i brezave të rinj me vlerat e sakrificës, lirisë dhe atdhedashurisë është mënyra më e mirë për ta nderuar gjakun e dëshmorëve. Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është festa e të gjithë shqiptarëve. Lavdi familjes Jashari! Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit dhe martirëve! Qoftë i përjetshëm kujtimi për ta!

Flamur Vojvoda: I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal, I nderuar kryetar i komunës, Të nderuar asamblistë, përfaqësues të institucioneve, familje të dëshmorëve, veteranë të luftës dhe qytetarë të respektuar. Me rastin e 5, 6 dhe 7 Marsit, përulemi me respektin më të thellë para Epopesë së Jasharëve, një ngjarje madhore që shënon një nga momentet më të rëndësishme në historinë tonë kombëtare. Në Prekaz, familja Jashari, nën udhëheqjen e Komandantit Legjendar Adem Jashari, dëshmoi para botës vendosmërinë dhe sakrificën e popullit tonë për liri. Qëndresa heroike e familjes Jashari nuk ishte vetëm një akt i jashtëzakonshëm trimërie, por edhe një shprehje e lartë e ndërgjegjes dhe dinjitetit kombëtar. Sakrifika e tyre u bë themel frymëzimi për rrugën çlirimtare të Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke bashkuar popullin tonë rreth idealit të shenjtë të lirisë dhe pavarësisë. Duke kujtuar me nderim të veçantë Komandantin Adem Jashari dhe familjen e tij heroike, riafirmojmë përkushtimin tonë për ta ruajtur dhe forcuar shtetin tonë, duke punuar çdo ditë për ndërtimin e një shoqërie të drejtë, të bashkuar dhe të përkushtuar ndaj vlerave të lirisë. Lavdi e përjetshme familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Të nderuar asamblistë. Të nderuar familjarë të dëshmorëve. Të nderuar qytetarë. Sërish erdhi marsi, marsi që na kujton 3 ditët e betejës, 3 brezat e familjes Jashari, 3 shkronjat e arta UÇK-së. Sot, në këtë seancë përkujtimore të ngjarjes historike të Epopesë së lavdishme të familjes Jashari, jemi mbledhur për të nderuar sakrificën sublime të familjes emblematike Jashari në 28-vjetorin e rënies së tyre. Jemi mbledhur për të nderuar Epopenë e UCK-se ato ditë të përgjakshme të marsit që u bënë kthesë për të ardhmen e ndritshme nga e kaluara e lavdishme e kësaj familjeje të Prekazit. Epopeja e Jasharajve e pasuron historinë tonë kombëtare, ku beteja në 3 ditët e ofensivës në mes të familjes Jashari dhe një artilerie të tërë ushtarake serbe e ngriti në pedestal ndërgjegjen e shqiptarëve për çështjen kombëtare ndërkombëtarizoi kauzën e popullit tonë nga përpjekja e kësaj familjeje për çlirim deri në vetëflijim, ndërsa përmasat e krimit gjenocidal të Sllobodan Milloshoviqit bënë dëshmi dhe hapen rrugët për intervenim ndërkombëtar. Sepse nuk ka ndonjë familje ku flijohen 3 breza për 3 dite për të hyre përjetësisht në analet e historisë. Këto ditë të marsit nuk janë thjesht një betejë e mosdorëzimit të familjes Jashari, që e deshën më shumë lirinë e vendit se jetën e tyre, por janë kulminacioni i përpjekjes shekullore në rrugën e gjatë e me shumë sakrifika të rezistencës së palëkundur të popullit shqiptar. Në vitin 1998, më datat 5, 6, 7 mars, në zemër të Drenicës, në Prekazin heroik e qëndrestar, forcat ushtarake dhe policore serbe ia mësynë kullave të familjes Jashari. Sulmet ishin të vazhdueshme dhe të ashpra në drejtim të tyre nga 4 anët, ndërsa rezistenca e familjes Jashari ishte e palëkundur. Ata u betuan se do të luftonin me aq armë sa kishin dhe siç thoshte Hamza në një video se kjo tokë nuk do të duronte tjetër kanë veç këmbës së shqiptarit, të bindur se Kosova do të çlirohej dhe se dorëzimi nuk ishte opsion. Ndërsa baci Shaban la lapsin në marsin e mësuesit, kapi pushkën

dhe ktheu marsin në betejën e Jasharajve. Në tokën e tyre, në një përballje të pabarabartë por të lavdishme, ra heroikisht komandanti legjendar Adem Jashari, me tërë familjen e tij të madhe, që ujitën tokën e Kosovës me gjakun e lirisë. Nga fëmijët flokëbardhë deri te nëna Zahide me shami në ballë. Nga kjo betejë, si dëshmi mbeti zëri i një fëmije, që sot është dëshmi e gjallë, zëri i Besartës. Sot, si kryetar i Komunës, e them me përgjegjësi të plotë morale e institucionale se liria jonë është rezultat i një historie që u shënuar me data, me emra, me gjak e me betim. Liri që solli pavarësinë e shtetit tonë, shtet ky i ndërtuar mbi sakrificë dhe përkushtim të brezave ndër vite. Le ta kujtojmë sot Prekazin jo vetëm si vend, por si simbol të forcës; le t'i kujtojmë dëshmorët jo vetëm me fjalë, por me punë; le ta kujtojmë luftën e fundit që Kosovës i solli fitoren dhe le ta ndërtojmë Kosovën ashtu siç e ëndërruan familja Jashari, të lirë e të fortë. Amaneti i dëshmorëve mbetet një thirrje e përjetshme për ne dhe brezat që do të vijnë pas nesh për ta mbrojtur lirinë dhe për ta fuqizuar shtetin, për të cilën ata sakrifkuan jetën e tyre. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit, lavdi Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lavdi Familjes Jashari. Zoti e Bekoftë Kosovën!

Kryesuesi mbylli mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës.

**Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:40 min.**

**Mitrovicë**

**Procesmbajtës:**

**Kryesuesi i mbledhjes**

\_\_\_\_\_  
**Afërdita MAXHUNI**

\_\_\_\_\_  
**Safet KAMBERI**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	10.03.2026
REFERENCË:	02-052/01-00 12909/20
PËR/ZA/TO:	z. Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit të Komunës z. Faton PEÇI – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Nazmi JASHARI – Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
NGA/OD/FROM:	z. Bedri MUJA – Kryetar i Komisionit për Hartimin e Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga Konsultimi Publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenin 32, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, Komisioni i formuar me Vendim nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026, ka shpall Diskutimin Publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024, për datën 27.02.2026, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00 h dhe mundësin për dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve përmes email adresës deri me datë 06.03.2026.

### Ecuria e procesit

Komisioni në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, ka publikuar Njoftimin

për Konsultim Publik të Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale në ueb faqen e Komunës 8 (tetë) ditë para mbajtjes së takimit në linkun: <https://mitroviccejugut.rks-gov.net/news/njoftim-per-konsultim-publik/në>, Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës (<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42985>), dhe në rrjetet sociale të Komunës.

Njoftimi për Konsultim Publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, respektivisht, nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, duke u interesuar që të sigurohet Njoftim i Plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me Njoftimin për Konsultim Publik palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik, përveç kësaj edhe mundësin për dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve përmes email adresës deri me datë 06.03.2026. Njoftimit i është bashkangjitur Draft – Rregullorja për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024 që ka qenë objekt i konsultimit publik, shpjegime shtesë, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Metodat e Konsultimit	Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Publikimi në ueb faqe	8 ditë para mbajtjes së takimit kryesor	12 Persona dhe atë në përbërje gjinore:  - 6 persona nga gjinia femërore dhe - 6 persona nga gjinia mashkullore

Në konsultim publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale kanë marrë pjesë: Komisioni Punues i Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024, Njësia për Komunikim me Publikun, përfaqësues të fshatrave dhe disa nga zyrtarët e drejtorive.

Në këtë Diskutim Publik nuk ka pasur kërkesa, komente apo rekomandime për ndryshime shtesë jashtë Draftit të punuar nga Komisioni, përveç se të pranishmit kërkuan sqarime shtesë lidhur me ndryshimet e propozuara në këtë Draft.

Përveç kësaj të pranishmit kanë ngritur çështjen e lehtësimit të procedurave për bartjes dhe regjistrimit të drejtës së pronësisë, për të cilat u njoftuan se kjo çështje është e trajtuar me akte ligjore dhe si e till nuk bie në fushë-veprimtarinë dhe objektin e kësaj rregulloreje.

Po ashtu sikurse në shpalljen e konsultimit publik, respektivisht deri me datë 06.03.2026 (c premtë) dhe në vijim nuk kemi pranuar ndonjë sugjerim apo koment në email adresë.

## **SHTOJÇË:**

*Lista e pjesëmarrësve në Diskutim Publik.*



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Nr. 01-020/04-0005970/26-2 dt. 27.02.2026

Mitrovicë

Lista e pjesëmarrjes në Tubimin Publik lidhur me Draft - Rregulloren për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024.

Nr.	Emri e Mbiemri	Datë	Nënshkrimi
1.	ISAK HAJRA	27.02.2026	
2.	XHIZLASHI BALIQ	27.02.2026	
3.	ALBANA AZEMI	27.02.2026	
4.	LUMTURIDE BRAHIMI	27.02.2026	
5.	Bedri Muja	27.02.2026	
6.	Mësheta Maxhuni	27.02.2026	
7.	Edmond JOSHANI	27.02.2026	
8.	Hana RUSHITI HAKAJ	27.02.2026	
9.	Merita METEKO	27.02.2026	
10.	VALON BASHIRI	27.02.2026	
11.	Refik AZEMI	27.02.2026	
12.	ICONIDA SHELITI	27.02.2026	
13.		27.02.2026	
14.		27.02.2026	
15.		27.02.2026	
16.		27.02.2026	
17.		27.02.2026	
18.		27.02.2026	
19.		27.02.2026	
20.		27.02.2026	
21.		27.02.2026	
22.		27.02.2026	
23.		27.02.2026	
24.		27.02.2026	
25.		27.02.2026	
26.		27.02.2026	
27.		27.02.2026	
28.		27.02.2026	
29.		27.02.2026	
30.		27.02.2026	
31.		27.02.2026	
32.		27.02.2026	
33.		27.02.2026	
34.		27.02.2026	



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Prot. 01-020/04-0005970/26-2

Datë 18.02.2026

Bazuar në dispozitat e nenit 68 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, neni 17 pika 1.2 dhe neni 22 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë dhe neni 14, nën-paragrafi 1.5 i Rregullorës (MAPL) nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, Komisioni i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës me nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026, organizon këtë:

### **KONSULTIM PUBLIK**

Për

Draft - Rregullore për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024.

Të nderuar qytetarë dhe subjekte të Komunës së Mitrovicës së Jugut, ju njoftojmë se Draft - Rregullorja për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024 ka hy në fazën e Konsultimit Publik, për çka ju ftoj që të merrni pjesë në konsultimin publik I caktuar të mbahet me datë 27.02.2026 (e premte), në ora 10<sup>00</sup> në Sallën e Mediave, kati I i-rë në objektin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Të drejtën e pjesëmarrjes e kanë të gjithë qytetarët dhe organizatat e ndryshme të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Këtij njoftimi iu bashkangjitet Draft - Rregullore për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024, ku mund ta gjeni të publikuar në webfaqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës së Jugut, <https://mitroviceejugut.rks-gov.net/>.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datë 06.03.2026 (e premte), në email adresën: [bedri.muja@rks-gov.net](mailto:bedri.muja@rks-gov.net).



Kryesues i Komisionit

Bedri Muja



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



**RREGULLORE PËR PLOTËSIM TË RREGULLORES KOMUNALE NR. 01/2022  
PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE TË  
ADMINISTRATËS KOMUNALE E NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME RREGULLOREN  
NR. 02/2024**

**Mars 2026**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Në bazë të dispozitave të nenit, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, dhe nenit 40, pika 40.2, shkronja a) të Ligjit Nr. 03L-040 Për vetëqeverisjen lokale, neni 4, 5, 6 dhe 7 Rregullores (MAPL) nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, 77 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Komisioni i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës me nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026, në mbledhjen e mbajtur me datë 10.02.2026, përgatiti këtë:

## **DRAFT**

### **RREGULLORE PËR PLOTËSIM TË RREGULLORES KOMUNALE NR. 01/2022 PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE E NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME RREGULLOREN NR. 02/2024**

#### **Neni 1**

Kjo rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësit e Administratës Komunale dhe Rregulloren nr. 02/2024.

#### **Neni 2**

1. Neni 19, paragraf 1, nënparagrafi 1.13 i Rregullorës bazë ndryshohet dhe riformulohet në Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër;
2. Neni 19, paragrafi 1 plotësohet si në vijim:  
1.15 Drejtoria e Pronës

#### **Neni 3**

Neni 36 , paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

#### **Neni 4**

Neni 38 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

#### **Neni 5**

1. Neni 80 i Rregullorës bazë, titulli ndryshohet dhe riformulohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.
2. Neni 80, paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:
3. Neni 80 i rregullorës bazë i fshihen nën-paragrafët 1.5, 1.6, 1.7, 1.12, 1.14, 1.18, 1.19, 1.20, 1.21 dhe 1.24.

#### **Neni 6**

1. Neni 81 i rregullorës bazë ndryshohet dhe riformulohet titulli në Organizimi i Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit.
2. Neni 81, paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet në: Funkzioni i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër do të bazohet në këta sektor:
3. Fshihet nën-paragrafi 1.3 i neni 81 i rregullorës bazë.

#### **Neni 7**

Fshihet neni 84 i rregullorës bazë.

#### **Neni 8**

Pas Neni 89 të rregullorës bazë, shtohet 4 nene te reja dhe atë:

**Neni 89A**  
**Drejtoria e Pronës**

1. Menaxhon me pronën në pronësi të komunës;
2. Zhvillon procedurën për vlerësimin e pronës sipas kritereve, standardeve dhe akteve normative në fuqi;
3. Kujdeset dhe mban evidencat e të dhënave pronësore ku bartës i të drejtës së pronësore dhe e shfrytëzimit është Kuvendi Komunal;
4. Nxjerr aktvendime, konkluzione dhe akte tjera konform dispozitave ligjore në fuqi;
5. Sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e konstestave për tokën;
6. Mbikëqyr zbatimin e kontratave që lidhen me shfrytëzimin afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale, dhe ndermarrjen e masave në rast të shkeljeve;
7. Kryen procedurat rreth transaksioneve të pronës publike dhe kryen procedurat e blerjes, dhënies në këmbim dhe shfrytëzim të pronës komunale.
8. Mbron pronën komunale-publike nga uzurpimet dhe udhëheq procedurat lidhur me këtë çështje;
9. Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për pronat që përfshihen në interes publik;
10. Administron me tatimin e pronës në pronësi të Komunës;
11. Menaxhon gjithë procesin e faturimit dhe pagesës;
12. Përditëson dhe korrigjon të dhënat përkatëse në regjistrat e tatimit në pronë, pas një inspektimi;
13. Përgatit strategji efektive të mbledhjes për të maksimizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore;
14. Mbledh, organizon dhe kryen verifikimin paraprak të informacionit të tregut që mund të përdoret për vlerësimin e pronave;

**Neni 89B**  
**Organizimi i Drejtorisë së Pronës**

1. Drejtoria e Pronës organizohet në këto sektor:
  - 1.1. Sektori i Pronës;
  - 1.2. Sektori për Shpronësime, Këmbime dhe Shfrytëzim të Pronës Komunale;
  - 1.3. Sektori i Tatimit në Pronë

**Neni 89C**  
**Sektori i Pronës**

1. Menaxhon me pronën e patundshme në pronësi të komunës përfshirë evidentimin, përditësimin dhe administrimin me pronën komunale;
2. Identifikimin e pronave të paregjistruara ose të pakonfirmuara dhe ndermarrjen e procedurave për regjistrimin e tyre;
3. Nxjerr aktvendime, konkluzione dhe akte tjera administrative;
4. Sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve pronësore dhe mbajtja e evidencës për pronat komunale që gjenden në procedurë gjyqësore;
5. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizik dhe juridik për rregullimin e mardhënieve pronësore-juridike lidhur me pronën komunale;
6. Mbron pronën komunale-publike nga uzurpimet dhe udhëheq procedurat lidhur me këtë çështje;
7. Kryerjen e detyrave të tjera që lidhen me kompetencat e sektorit të pronës sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 89D**  
**Sektori për Shpronësime, Këmbime dhe Shfrytëzim të Pronës Komunale**

1. Kujdeset dhe mban evidencat e të dhënave pronësore ku bartës i të drejtës pronësore dhe e shfrytëzimit është Kuvendi Komunal;
2. Administrimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të kontratave dhe kushteve të tyre;
3. Kryen procedurat rreth transaksioneve të pronës së patundshme komunale, realizim e pagesave nga kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale dhe zbaton procedurat e blerjes, këmbimit dhe të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;
4. Bënë vërtetimin dhe zbaton procedurat për shitblerjen e pronës së patundshme;
5. Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për pronat që përfshihen në interes publik;
6. Nxjerr aktvendime, konkluzione dhe akte tjera administrative;
7. Kryerjen e detyrave të tjera që lidhen me kompetencat e sektorit sipas legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të Kuvendit Komunal.
8. Shqyrton ankesat kundër fatures së tatimit në pronë dhe ankesat e tjera në pajtim me Ligjin dhe aktet përkatëse nënligjore për procedurat ankimore;
- 9.

**Neni 89E**

1. Zyra e Tatimit në Pronë kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:

- 1.1. Administron me tatimin e pronës në pronësi të Komunës;
- 1.2. Regjistron, azhuron dhe menaxhon të dhënat e marra nga burimet e vetë deklarimit të palës dhe nga inspektimi;
- 1.3. Korrigjon të dhënat përkatëse në regjistrat e tatimit në pronë, pas konstatimit të pasaktësive;
- 1.4. Përditëson dhe korrigjon të dhënat përkatëse në regjistrat e tatimit në pronë, pas një inspektimi;
- 1.5. Korrigjon të dhënat përkatëse në regjistrat e tatimit në pronë, pas pranimit të një ankese me vendim administrativ ose gjyqësor të formës së prerë;
- 1.6. Bën ndryshimet e nevojshme në regjistrat e tatimit në pronë në pajtim me Ligjin;
- 1.7. Nxjerr dhe përpunon raport të ndryshme nga sistemi i tatimit në pronë sipas kërkesës dhe nevojës;
- 1.8. Menaxhon gjithë procesin e faturimit dhe pagesës;
- 1.9. Kontrollon nëse elementet e ndryshme të faturave të tatimit në pronë janë në përputhje me Ligjin;
- 1.10. Identifikon faturat e tatimit në pronë që nuk duhet të lëshohen në hazë të Ligjit;
- 1.11. Shtyp faturat e tatimit në pronë pas procedurës së kontrollit;
- 1.12. Shtyp çertifikaten e vlerës së vlerësuar;
- 1.13. Kontrollon nëse pagesa e detyrimeve është bërë në kohë, dhe monitoron marreveshjet për pagesën e detyrimeve tatimore të papaguara me këste;
- 1.14. Shtyp kartelen financiare në bazë të kërkesës dhe përgatit vërtetimin e pagesës pas kërkesës për lëshimin e vërtetimit;
- 1.15. Përgatit në kohë njoftimin përfundimtar për pagesë;
- 1.16. Kërkon në kohë nga zyrat, drejtoritë e ndryshme brenda Komunës, pezullimin e shërhimeve komunale;
- 1.17. Përgatit në kohë vendimin për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara;
- 1.18. Përgatit propozimin për përmbarim;
- 1.19. Pezullon procedurat e mbledhjes së detyrueshme për rastet e parashikuara me Ligj;
- 1.20. Heton dhe bashkëpunon me të gjitha autoritetet publike, personat juridike ose organet që administrojnë ose kanë në dispozicion informacionin e nevojshëm për pronën e debitorit (pasurinë, asetet);
- 1.21. Aplikon, nëse është e nevojshme, metoda të vlerësimit të rrezikut, për të përcaktuar dhe zbatuar në çdo rast masat me të përshtatshme për të maksimizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara;
- 1.22. Rimburëson tatimpaguesin ose debitorin;
- 1.23. Përgatit strategji efektive të mbledhjes për të maksimizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore;
- 1.24. Raporton në baza të rregullta mbi aktivitetet e mbledhjes në divizionin përkatës për inspektimin dhe mbledhjen e detyruar në Departamentin e Tatimit në Pronë;
- 1.25. Identifikon pronat që do të taten dhe pronat që do të lirohen;
- 1.26. Identifikon tatimpaguesit sipas Ligjit dhe kryen hetime administrative për këtë qëllim, nëse është e nevojshme;
- 1.27. Përgatit dhe paraqet kërkesat për iniciimin e procedurës së trashëgimisë në përputhje me Ligjin;
- 1.28. Bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, gjykatat apo çdo autoritet tjetër publik, kompetent për të shqyrtuar rastet e

uzurpimeve të paligjshme;

1.29. Klasifikon pronat e paluajtshme dhe Inspekton pronat e paluajtshme;

1.30. Mbledh, organizon dhe kryen verifikimin paraprak të informacionit të tregut që mund të përdoret për vlerësimin e pronave;

1.31. Konstaton shkeljet e dispozitave ligjore dhe propozon vendosjen e gjobës/gjobave përkatëse;

1.32. Dërgon/dorëzon njoftimet, faturat e tatimit në pronë, çertifikatat e vlerës se vlerësuar dhe aktet e tjera zyrtare;

1.33. Shqyrton kërkesat për shtyrjen e afatit për pagesën e detyrimeve tatimore në përputhje me Ligj dhe aktet përkatëse nënligjore;

1.34. Shqyrton kërkesat për korrigjim në pajtim me aktin përkatës nënligjor për procedurat e ankimore;

1.35. Shqyrton ankesat kundër fatures së tatimit në pronë dhe ankesat e tjera në pajtim me Ligjin dhe aktet përkatëse nënligjore për procedurat ankimore;

1.36. Bashkëpunon dhe shkëmben informacion me të gjitha autoritetet publike, personat juridike ose organet që administrojnë ose kanë në dispozicion informacionin e nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të kërkesave për shtyrje dhe ankesave;

1.37. Asiston tatimpaguesit, debitorët, personat e interesuar ose përfaqësuesit e tyre në ushtrimin e të drejtave dhe/ose permbushjen e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë, përfshirë, por duke mos u kufizuar në: plotësimin dhe paraqitjen e vetë - deklarimeve të ndryshme të kërkuara nga Ligji dhe aktet nënligjore, plotësimin dhe paraqitjen e ankesave, plotësimin dhe paraqitjen e kërkesave për shtyrje të afatit për pagese, kërkesave për rivlerësimin e pronës ose kërkesa të tjera; dhe perdorimin e shërbimeve të ndryshme elektronike;

1.38. Siguron që publiku të merr informacion të saktë dhe në kohë përmes kanaleve të ndryshme informon publikun mbi legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë dhe mënyrën se si përdoren të hyrat nga tatimi në pronë në Komunë, kryen fushata të ndryshme informuese dhe asiston Departamentin e Tatimit në Pronë në kryerjen e fushatave informuese, shpall në ambientet e Komunës dhe publikon në faqen elektronike të Komunës njoftimet e kërkuara në bazë të Ligjit, dhe siguron që çdo lloj informacioni të shpallet ose publikohet në secilen prej gjuhëve zyrtare të Komunës, në të njëjten shpallje/publikim dhe në të njëjtën mënyrë;

1.39. Sqaron tatimpaguesit, debitorët, personat e interesuar ose përfaqësuesit e tyre në lidhje me legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë dhe aktet e nxjerra gjatë zbatimit të tij.

## Neni 9

Në afatin prej 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Kryetari i Komunës nxjerr organogramin e përgjithshëm të Komunës së Mitrovicës dhe organogramet për drejtoritë, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

## **Neni 10**

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullorje është Lista e Klasifikimit të Pozitave për Shërbimin Civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

## **Neni 11**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore do të hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Mitrovicë**


**Kryesuesi i Kuvendit**

---

**Safet Kamberi**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0005970/26 dt. 02.02.2026  
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Kërkesën Elektronike nga z. Shkelzen Haliti – Kabineti i Kryetarit, dt. 28.01.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

## V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024)

- 1. FORMOHET** Komisioni për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024, në këtë përbërje:
  - 1.1** Bedri Muja – kryetar (Drejtoria e Inspektionit);
  - 1.2** Lumturiye Brahimi – anëtare (Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë);
  - 1.3** Albana Azemi – anëtare (Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë).
- Komisioni është përgjegjës që të bëjë ndryshimin e Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024, duke shqyrtuar propozimet për ndryshime nga Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë Komunale, dhe të bëjë harmonizimin e këtyre ndryshimeve sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores për Ndryshimin e Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.
- Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullorën (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e



## Merita Preteni

---

**From:** Besa Veseli  
**Sent:** e hënë, 16 shkurt 2026 13:52  
**To:** Bedri Muja  
**Subject:** Arsyetim lidhur me komponenten gjinore

I nderuar,

Pasi që kjo rregullore paraqet akt për plotësim dhe ndryshim të Rregullores baze Nr. 01/2022 dhe nuk përben akt të ri normativ. Dispozitat e saj kanë karakter organizativ dhe strukturor, duke rregulluar ndarjen e kompetencave dhe organizimin e brendshëm të administratës komunale.

Theksoj se në hartimin e rregullores baze Nr. 01/2022 kam dërguar komentet për përfshirjen e parimeve të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, ndërsa për këtë akt plotësues vlerësoj se nuk cenon, ndryshon apo kufizon parimet e barazisë gjinore të përcaktuara në legjislacion.

Terminologjia e përdorur në këtë Rregullore është neutrale dhe zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha gjinitë.

Me respekt,

Besa Veseli – Zyrtare për Barazi Gjinore  
Email: Besa.Veseli@rks-gov.net  
Tel: 049734760

**From:** Bedri Muja <Bedri.Muja@rks-gov.net>  
**Sent:** Friday, February 13, 2026 1:40 PM  
**To:** Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>  
**Cc:** Enis Osmani <enis.osmani@rks-gov.net>; Albana Azemi <Albana.Azemi@rks-gov.net>; Lumturije Brahimi <lumturije.brahimi@rks-gov.net>  
**Subject:** Përshtetja!

Të nderuar,

Shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbar,

Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0005970/26 i datës 02.02.2026 ka formuar Komisionin për Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores 02/2024.

Në cilësi të Kryetarit të Komisionit, ju njoftoj se Komisioni ka përfunduar Draftin Final në bazë të rekomandimeve që i kemi marrë nga Drejtoritë/Njësitë përkatëse, të cilin po ju bashkangjesim në attach, së bashku me Rregulloren bazë.

Ju lutem që të analizoni këtë Draft, dhe të na konfirmoni harmonizimin e tij dhe zbatimin e teknikave të aktit secili për fushën e tij, duke përfshirë aspektin ligjor dhe financiar dhe sugjerimet të i dërgoni më së largu deri më datë 17.02.2026 (ditën e Marte) në ora 14:00 h.

(Drafti në fjalë mund të ketë gabime drejtëshkrimore për të cilat do ti korigjojme në zhvillim të këtij procesi).  
)

Në emër të komisionit ju falenderojë për angazhimin tuaj.

## Merita Preteni

---

**From:** Zenel Citaku  
**Sent:** e hënë, 16 shkurt 2026 11:23  
**To:** Bedri Muja  
**Cc:** Enis Osmani; Albana Azemi; Lumturije Brahim; Lulzim Hajra; Lavdim Musa; Besa Veseli  
**Subject:** RE: Pershendetje!

Të nderuar/a,

Në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Financiar, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Ndryshim-Plotësim të Rregullores nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe të Rregullores nr. 02/2024, ju njoftoj lidhur me aspektin buxhetor-financiar si në vijim:

Buxheti i Komunës për vitin 2026 është i aprovuar, ndonëse ende nuk ka hyrë në zbatim, pasi që aktualisht jemi duke operuar me ndarjet e përkohshme mujore (1/12) të Buxhetit të vitit 2025. Çdo ndryshim eventual në strukturën organizative që implikon krijimin e kodeve të reja buxhetore, përfshirë edhe kod të veçantë për Drejtorinë e Pronës, nuk mund të realizohet në këtë fazë të vitit fiskal.

Krijimi i kodit të ri buxhetor mund të bëhet vetëm në kuadër të procesit të rishikimit të buxhetit dhe pas marrjes së aprovimeve dhe lejimeve të nevojshme nga Ministria e Financave, përkatësisht përmes reflektimit në sistemin BDMS.

Deri në përfundimin e këtyre procedurave, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit dhe Drejtoria e Pronës do të vazhdojnë të operojnë në kuadër të të njëjtit kod buxhetor ekzistues.

Nga këndvështrimi buxhetor-financiar, Draft-Rregullorja nuk paraqet implikime shtesë financiare në buxhetin e aprovuar për vitin 2026, me kusht që organizimi dhe funksionimi i njërive të përfshira të mbetet brenda kornizës së ndarjeve buxhetore ekzistuese deri në rishikimin e buxhetit.

Me respekt,

**From:** Bedri Muja <Bedri.Muja@rks-gov.net>  
**Sent:** Friday, February 13, 2026 1:40 PM  
**To:** Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>  
**Cc:** Enis Osmani <enis.osmani@rks-gov.net>; Albana Azemi <Albana.Azemi@rks-gov.net>; Lumturije Brahim <lumturije.brahimi@rks-gov.net>  
**Subject:** Pershendetje!

Të Nderuar,

Shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbar,

Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0005970/26 i datës 02.02.2026 ka formuar Komisionin për Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores 02/2024.

Ne cilësi të Kryetarit të Komisionit, ju njoftoj se Komisioni ka përfunduar Draftin Final në bazë të rekomandimeve që i kemi marrë nga Drejtoritë/Njësitë përkatëse, të cilin po ju bashkangjesim në attach, së bashku me Rregulloren bazë.

Ju lutem që të analizoni këtë Draft, dhe të na konfirmoni harmonizimin e tij dhe zbatimin e teknikave të aktit secili për fushën e tij, duke përfshirë aspektin ligjor dhe financiar dhe sugjerimet të i dërgoni më së largu deri më datë 17.02.2026 (ditën e Marte) në ora 14:00 h.

(Drafti në fjalë mund të ketë gabime drejtëshkrimore për të cilat do ti korigjojm në zhvillim të këtij procesi).

)

Në emër të komisionit ju falenderojë për angazhimin tuaj.

## Merita Preteni

---

**From:** Lulzim Hajra  
**Sent:** e hënë, 16 shkurt 2026 11:18  
**To:** Bedri Muja  
**Cc:** Enis Osmani; Albana Azemi; Lumturije Brahimi; Zenel Citaku; Lavdim Musa; Besa Veseli  
**Subject:** RE: Pershendetje!

Përshendetje të nderuar, fillimisht ju përgëzoj për punën dhe angazhimin në hartimin e kësaj draft rregullore.

Fillimisht numri i protokollit dhe data duhet të largohen sepse i vendos Sekretaria e Kuvendit, pas miratimit.

Në preambulë pas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale duhet përfshirë edhe Statuti i Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, konkretisht neni 13 paragrafi 1 nënparagrafi 3, neni 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1, dhe nani 84 paragrafi 2.

Në titull të Draftit, tek emërtimi e cekni: Rregullore për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Komunale... Tutje në rastet kur riformulohet neni apo paragrafi apo edhe në rastet kur shtohet një i tillë, duhet cekur “riformulohet/shtohet si në vijim:”, pastaj vazhdon në kryerresht duke startuar me numrin e neni ose paragrafit, pastaj teksti. Kjo praktikë duhet përcjellur në tërë tekstin.

Në nenin 5, ku keni cekur “Fshihet neni 84 i rregullores bazë”, duhet cekur “Neni 84 i Rregullores bazë fshihet dhe Riformulohet si në vijim”. Dhe këtu pra në nenin 84 vazhdoni me Drejtorinë e krijuar – Neni 84, Drejtoria e Pronës, tutje me paragrafë specifikoni detyrat dhe përgjegjësit.

Pastaj tek neni 5 i Draftit ku specifikoni “Pas Nenit 89 të rregullores bazë, shtohen 4 nene të reja dhe atë:”, duhet të specifikoni që pas Nenit 84 të Rregullores bazë shtohen edhe 3 nene të reja (Neni 84 A Organizimi i Drejtorisë së Pronës – 84 B, Sektori i Pronës dhe 84 C Sektori për Shpronësim, Këmbim dhe Shfrytëzim të Pronës Komunale).

Si dhe neni 9 i Draftit - Hyrja në fuqi duhet riformuluar

Kjo Rregullore shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Kjo Referuar Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin e Detyrueshëm të Akteve Komunale dhe Rregullores (MAPL) nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës.

Siç e keni cekur edhe ju para procedimit duhet bërë edhe lekturimi.

Duke shpresuar në mirëkuptimin nga ana e juaj, ne ju përsëndesim.

Gjitha të mirat.

**From:** Bedri Muja <Bedri.Muja@rks-gov.net>

**Sent:** Friday, February 13, 2026 1:40 PM

**To:** Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>

**Cc:** Enis Osmani <enis.osmani@rks-gov.net>; Albana Azemi <Albana.Azemi@rks-gov.net>; Lumturije Brahimi <lumturije.brahimi@rks-gov.net>

**Subject:** Pershendetje!

Të Nderuar,

Shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbar,

Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0005970/26 i datës 02.02.2026 ka formuar Komisionin për Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores 02/2024.

Ne cilësi të Kryetarit të Komisionit, ju njoftoj se Komisioni ka përfunduar Draftin Final në bazë të rekomandimeve që i kemi marrë nga Drejtoritë/Njësitë përkatëse, të cilin po ju bashkangjesim në attach, së bashku me Rregulloren bazë.

Ju lutem që të analizoni këtë Draft, dhe të na konfirmoni harmonizimin e tij dhe zbatimin e teknikave të aktit secili për fushën e tij, duke përfshirë aspektin ligjor dhe financiar dhe sugjerimet të i dërgoni më së largu deri më datë 17.02.2026 (ditën e Marte) në ora 14:00 h.

(Drafti në fjalë mund të ketë gabime drejtëshkrimore për të cilat do ti korigjojm në zhvillim të këtij procesi).

)

Në emër të komisionit ju falenderojë për angazhimin tuaj.